



Instrumenti për Përafrimin me Acquis të BE-së

Mbështetja e Mëtejshme për Zhvillimin e Tregtisë në Kosovë

**Nr. identifikues i projektit Nr.
EuropeAid/138565/DH/SER/XK
Kontrata për shërbime Nr. 2018/395-320**

DOKUMENT PËR SHËRBIME

21 Dhjetor 2018



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Projekt që zbatohet nga
GFA Consulting Group GmbH
Zyra Daneze për Patenta dhe Marka Tregtare
Instituti Evropian për Politika Publike
WTI Advisors LTD

Personat tuaj kontaktues brenda
GFA Consulting Group GmbH:

Znj. Martina Bernauer (Drejtoreshë e Projektit)

Ky dokument fillimisht është shkruar në gjuhën angleze

Kosovë

Mbështetja e mëtejshme për zhvillimin e tregtisë në Kosovë
Kontrata me numër 2018/395-320

Aktiviteti 2.1.4

Dokument për Shërbime

Autorët:

Luis Abugattas (Udhëheqës i Ekipit)
Shqipe Jashari-Sekiraqa
Mirsad Simnica
Osman Džudžević

Mohim i Përgjegjësisë

Përmbajtja e këtij publikimi është nën përgjegjësi vetëm të autorëve dhe GFA Consulting Group GmbH dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret sikur i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian

GFA Consulting Group GmbH

Eulenkrogstr. 82
D-22359 Hamburg
Gjermani

Numri i telefonit: +49 (40) 6 03 06 170
Faksi: +49 (40) 6 03 06 159
E-mail: martina.bernauer@gfa-group.de



An EU funded project
managed by the
European Union Office in
Kosovo

Implemented by





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

DEPARTAMENTI I TREGTISË / DEPARTAMENT TRGOVINE / DEPARTMENT OF TRADE

DRAFTI I PARË DOKUMENT PËR DISKUTIM

Shërbimet në Ekonominë e Kosovës: Sfidat dhe Mundësitë për Rritje dhe Zhvillim të Qëndrueshëm



An EU funded project
managed by the
European Union Office in
Kosovo

Implemented by



DANISH PATENT AND TRADEMARK OFFICE



Përmbajtja

I. HYRJE	3
II. SHËRBIMET: RRITJA EKONOMIKE DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	4
III. EKONOMIA E SHËRBIMEVE TË KOSOVËS.....	7
3.1. Struktura e sektorit të shërbimeve të Kosovës	7
3.2. Punësimi në Aktivitetet e Shërbimeve.....	11
3.3. Modeli i Ndryshimit Strukturor të Ekonomisë së Kosovës	14
IV. TREGTIA NË SHËRBIME NË KOSOVË.....	17
4.1 Pasqyra e tregtisë.....	18
4.2 Modeli i Tregtisë së Shërbimeve të Kosovës.....	23
4.2.1 Transporti	24
4.2.2 Udhëtimi	28
4.2.3 Shërbimet e Biznesit	31
4.2.4 Shërbimet Personale, Kulturore dhe Rekreative	39
4.2.5 Shërbimet qeveritare	40
V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	40



I. HYRJE

Ekonomia e Kosovës është kryesisht një "ekonomi e shërbimeve". Sektori i shërbimeve ka dalë si segmenti më i madh i ekonomisë dhe si forcë e saj shtytëse, duke kontribuar me një përqindje të rritur të vlerës së shtuar vendore, punësimit dhe tregtisë. Aktivitetet e shërbimeve në vitin 2017 kanë përbërë 71.9 për qind të PBV-së me çmime bazë, dhe kanë gjeneruar 81.2 për qind të totalit të punësimit formal në vend. Ajo që është më e rëndësishme, aktivitetet e shërbimeve përbëjnë shtyllën e sektorit privat të Kosovës. Aktivitetet e shërbimeve përbëjnë 86 për qind të firmave të përgjithshme të regjistruara në vend, dhe paraqesin 82.6 për qind të totalit të punësimit në sektorin privat. Aktivitetet e shërbimeve gjenerojnë 87.3 për qind të qarkullimit të përgjithshëm të firmave në ekonomi, dhe përfaqësojnë 88.8 për qind të shpenzimeve të përgjithshme.

Rëndësia relative e shërbimeve në ekonomi është rritur në mënyrë progresive me kalimin e kohës, dhe zhvendosja drejt shërbimeve është përsheptuar vitet e fundit. Gjatë periudhës 2012-2017, 81 për qind e të gjithë ndërmarrësve që kanë hyrë në treg kanë qenë në aktivitetet e shërbimeve; dhe sektori i shërbimeve gjeneroi 87 për qind të të gjitha punësimeve të reja. Në të njëjtën kohë, tregtia në shërbime përbën një element thelbësor në integrimin e Kosovës në ekonominë globale. Për dallim me rastin e tregtisë në mallra, ku vendi vuan nga një deficit strukturor në rritje, Kosova ka shënuar suficit të tregtisë në shërbime, e cila ka qenë e dobishme në kontributin për financimin e pjesëshëm të llogarisë rrjedhëse të Bilancit të Pagesave (BOP).

Roli kyç që shërbimet kanë në rritjen ekonomike, në konkurrueshmërinë sistematike të një ekonomie dhe në zhvillimin e përgjithshëm sot është ngërthyer mirë në literaturë. Aktivitetet efikase të shërbimeve, të integruara në mënyrë efektive me sektorët tjerë produktiv të ekonomisë, njihen gjerësisht si parakusht dhe si kusht i domosdoshëm për të arritur norma adekuate të rritjes ekonomike, të integritit produktiv në ekonominë globale dhe në përmirësimet e përgjithësuar në mirëqenien e popullatës. Megjithatë, madhësia e dukshme sektorit të shërbimeve nuk është një tregues në vetvete i rolit që këto aktivitete luajnë në mbështetjen e rritjes ekonomike, konkurrueshmërisë dhe përmirësimeve të mirëqenies.

Ky dokument shqyrton strukturën dhe performancën e shërbimeve në ekonominë e Kosovës dhe në tregtinë e Kosovës; duke synuar ofrimin e informacioneve për eksplorimin e politikave alternative që do t'i kontribuonin rritjes së rolit të aktiviteteve të shërbimeve deri në aspiratat zhvillimore të Kosovës. Seksioni i mëposhtëm paraqet një diskutim të shkurtër të rolit të shërbimeve në rritje dhe zhvillim, për të siguruar kornizën e përgjithshme që udhëzon analizën e seksioneve pasuese. Seksioni i dytë shqyrton strukturën dhe performancën e sektorit të shërbimeve në ekonominë e Kosovës; duke vlerësuar shkallën dhe natyrën e kontributit të tij në rritje dhe zhvillim. Seksioni i katërt ofron një vlerësim të tregtisë së Kosovës në shërbime. Seksioni i fundit diskuton konkluzionet kryesore që rrjedhin nga analiza, dhe sugjeron disa rekomandime të politikave mbi mënyrat dhe mjetet që mund të eksploroohen për të maksimizuar kontributin e shërbimeve në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ky dokument është përafrimi i parë për çështjen e shërbimeve dhe zhvillimit në Kosovë; prandaj, i kushtohet vëmendje e duhur identifikimit të zonave që kërkojnë hulumtim dhe vlerësim të mëtejshëm.



II. SHËRBIMET: RRRITJA EKONOMIKE DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Sektori i shërbimeve përbëhet nga një shumëllojshmëri e gjerë e aktiviteteve tregtare dhe jo tregtare, duke filluar nga transporti dhe shitja me pakicë, e deri tek hotelet, restorantet, aktivitetet financiare, shërbimet biznesore dhe personale, arsimore, shëndetësore dhe të administratës publike¹. Rëndësia e aktiviteteve të shërbimeve dhe roli i tyre vendimtar në rritjen ekonomike dhe zhvillimin social tashmë është i ngërthyer mirë në analizën ekonomike. Literatura ekonomike ka theksuar dhe demonstruar, nëpërmjet studimeve të panumërta, rëndësinë e shërbimeve; duke identifikuar fushat kryesore në të cilat këto aktivitete luajnë një rol të pazëvendësueshëm në një proces të rritjes ekonomike të bazuar në produktivitet. Aktualisht, vëmendja është e përqendruar në sqarimin se cilat do të ishin politikat më të mira për forcimin e kapaciteteve vendore në aktivitetet e shërbimeve dhe rritjen e kontributit të tyre në mirëqenie dhe zhvillim ekonomik.

Ka shumë argumente të fuqishme që mbështesin nevojën për t'i kushtuar vëmendje më të veçantë rolit të aktiviteteve të shërbimeve në rritje dhe zhvillim, dhe veçanërisht në politikë-bërje ekonomike. Së pari, për shkak se përbëjnë pjesën kryesore të ekonomisë; por, mbi të gjitha, për shkak se aktivitetet e shërbimeve janë gjithnjë e më të integruara në sistemin e përgjithshëm të prodhimit. Të gjitha aktivitetet e prodhimit të mallrave, si dhe shumica e industrive të shërbimeve, vetë kërkojnë shërbime si inpute për të prodhuar modelet për të shpërndarë mallrat dhe/ose shërbimet finale. Së dyti, për shkak se industritë e shërbimeve janë duke luajtur një rol gjithnjë e më aktiv në procesin e globalizimit dhe në integrimin e tregut, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Së treti, krijimi i vendeve të reja të punës, vlera e shtuar dhe të ardhurat janë gjithnjë e më të lidhura me performancën e ekonomisë së shërbimeve. Së fundi, duhet t'i kushtohet vëmendje sepse zhvillimi i aktiviteteve të caktuara të shërbimeve (arsimi, shëndetësia, koha e lirë dhe shërbimet personale) lidhet drejtpërdrejt me rritjen e mirëqenies së përgjithshme të popullatës.

Kutia Nr. 1² paraqet një pasqyrë të shkurtër të rolit të aktiviteteve të ndryshme të shërbimeve në ekonomi dhe në nxitjen e rritjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

¹ Në këtë dokument, klasifikimi i aktiviteteve të shërbimeve ndjek ato të miratuara në Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tregtinë në Shërbime (GATS) të OBT-së. Shërbimet përfshijnë distribucionin e energjisë elektrike dhe ujit, si dhe ndërtimtarinë.

² Bazuar në Abugattas, L and Zarilli, S (2007). "Challenging Conventional Wisdom: Development Implications of Trade in Services Liberalization". UNCTAD, Nju Jork dhe Gjenevë.



KUTIA 1

Shërbimet financiare, të telekomunikacionit, të distribucionit të energjisë elektrike dhe shërbimet e transportit dhe ato të ndërlidhura logjistike përbëjnë rrjetet bazë të ekonomisë që lejojnë funksionimin e sistemit të përgjithshëm ekonomik. Këto shërbime lidhin ekonominë, dhe duke qenë inpute të menjëhershme në prodhim në të gjithë sektorët, disponueshmëria, çmimi dhe cilësia e tyre përcaktojnë deri në një shkallë të madhe konkurrueshmërinë sistematike të një ekonomie.

Tregjet materializojnë përmes shërbimeve të distribucionit, të ashtuquajturat tregtimit distributive, dhe efikasiteti dhe marzhat e tyre operacionale kanë ndikim të madh në nivelet e përgjithshme të çmimeve në ekonomi. Shërbimet e distribucionit me shumicë dhe pakicë janë një lidhje jetike ndërmjet prodhuesve dhe klientëve, me marzha që aplikohen në ofrimin e shërbimeve të tilla që ndikojnë në konkurrueshmërinë e firmave në tregun vendor dhe atë ndërkombëtar

Shërbimet arsimore dhe shëndetësore janë thelbësore për zhvillimin dhe riprodhimin e kapitalit njerëzor, që botërisht dihet se sjellë kthime të konsiderueshme ekonomike dhe sociale.

Shërbimet profesionale dhe të ashtuquajturat shërbime prodhuese, janë përgjegjëse për gjenerimin, shpërndarjen dhe zbatimin e "njohurive" të cilat, në kontekst të ekonomisë së njohurive në zhvillim, gjithnjë e më shumë përbëjnë një ndërlidhje kruciale ndërmjet gjenerimit të njohurive dhe përpjekjeve prodhuese dhe sociale. Shërbimet profesionale rrisin performancën e firmave të tjera përmes kërkimit dhe zhvillimit dhe përmirësimit organizativ, duke e bërë teknologjinë bazë të produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së rritur.

Shërbimet e kontabilitetit dhe ato juridike përbëjnë komponentët më të rëndësishme të infrastrukturës së përgjithshme të kërkuar të një ekonomie të tregut. Pa ofrim adekuat të këtyre shërbimeve nuk do të ishte i mundur asnjë aktivitet i shëndoshë ekonomik. Përtej informacionit shumë-qëllimor që ofrojnë shërbimet e kontabilitetit, ato janë themeli i sistemeve fiskale të vendeve, si dhe luajnë një rol kyç në qeverisjen e korporatave. Nga ana e tyre, shërbimet juridike përcaktojnë zbatimin adekuat të ligjeve dhe rregulloreve, mbrojtjen e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe lehtësimin e zgjidhjes së konflikteve duke lejuar funksionimin adekuat të tregjeve.

Shërbimet si industritë kulturore dhe një numër i shërbimeve sociale, komunale dhe qeveritare janë thelbësore në zhvillimin e asaj që është përcaktuar në literaturën ekonomike si "kapital social", duke i kontribuar kohezionit të brendshëm social dhe kulturor të shoqërisë, që garanton rritje ekonomike ose mirëqenie të përgjithshme njerëzore. Për më tepër, shërbimet tjera, si shërbimet e argëtimit, restorantet dhe hotelet dhe shërbimet personale, gjersa gjenerojnë punësim të rëndësishëm, kontribuojnë ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetës në shoqëri.

Shërbimet kontribuojnë gjithnjë e më shumë në integrimin e ekonomive kombëtare në sistemin e tregtimit ndërkombëtar. Tregtia në shërbime është një element shumë dinamik në ekonominë botërore: integrimi efikas në një ekonomi botërore të shërbimeve e cila është në zhvillim po bëhet kruciale për perspektivat e zhvillimit të shumë vendeve në zhvillim. Shërbimet gjithashtu kryejnë një funksion të rëndësishëm në koordinimin e proceseve të prodhimit brenda vendit dhe gjithnjë e më shumë në vendet tjera. Prandaj shërbimet luajnë një rol vendimtar edhe në fizibilitetin dhe funksionimin e zinxhirëve globalë të vlerave.

Ekziston një numër trendësh që po evoluojnë në mbarë botën, që kanë rritur rëndësinë e shërbimeve si nxitës të transformimit strukturor të ekonomive që përmirëson rritjen, si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në ato në zhvillim. Shumë aktivitete të shërbimeve, veçanërisht të ashtuquajturat shërbime "*të prodhuesit*" ose "*të biznesit*", kanë dalë të jenë si "*nxitës të produktivitetit/konkurrueshmërisë*" përmes lidhjeve të gjithanshme me sektorët e tjerë të ekonomisë. Këto aktivitete, përmes rolit të tyre mundësues, kanë një ndikim të konsiderueshëm në rritjen e përgjithshme të faktorëve të produktivitetit, diversifikimit dhe potencialit gjithëpërfshirës të rritjes. Një trend i rëndësishëm që vë në pah rolin në rritje të shërbimeve është se firmat që



prodhojnë mallra po bëhen më të specializuara në aktivitetet e tyre kryesore, duke kontraktuar gjithnjë e më shumë aktivitetet e tyre jo-thelbësore tek *sektori i shërbimeve të biznesit*. Prodhimi i mallrave përfshin gjithnjë e më shumë kombinimin e funksioneve të prodhimit dhe shërbimeve, dhe ekziston një zhvendosje e rëndësishme nga prodhimi, që varet nga burimet materiale në prodhimin që përdor njohuritë si burim kyç në konkurrueshmëri dhe inovacion. Ky riorganizim është duke përparuar shpejtë pasi që ndryshimi teknologjik ul kostot e komunikimit dhe logjistikës nëpër firma dhe shtete, dhe ka lejuar që një numër i madh procesesh të automatizohen, duke rritur fushëveprimin dhe kompleksitetin e asaj që mund të kontraktohet (*outsourcing*) tek firmat tjera të jashtme. Disa kontraktime (*outsourcing*) të shërbimeve kanë çuar në ndryshime vetëm në industri, ku regjistrohet një aktivitet ekzistues; por po shfaqen gjithnjë e më shumë shërbime të reja dhe inovative të biznesit.

Kontraktimi (*outsourcing*) i shërbimeve të biznesit tek ofruesit e dedikuar, edhe në aspekte tradicionale, pritet të sjellë përfitime të konsiderueshme të efikasitetit që rezultojnë nga specializimi dhe ekonomitë e shkallës (*economies of scale*). Është treguar se produktiviteti i sektorit të shërbimeve çon peshë për produktivitetin e firmave më të vogla që prodhojnë mallra, dhe më shumë për ato firma që përdorin shërbime relativisht intensive në kombinimin e tyre të përgjithshëm të inputeve. Ekzistojnë po ashtu dëshmi se natyra e punës që bëhet në sektorin e shërbimeve të biznesit është duke ndryshuar përgjithësisht më shpejt se në sektorët tjerë, dhe zhvillimi i mënyrave të reja për të ofruar shërbime që kërkojnë njohuri të specializuara sugjeron fuqishëm që shërbimet e biznesit janë në qendër të ndryshimit teknologjik që po transformon rrënjësisht ekonomitë e mbarë botës.

Analiza të ndryshme të kryera, si në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, tregojnë se komponenti i "shërbimeve" të prodhimit të materialeve ndjek një lakore rritëse në krahasimet e hyrje-daljeve, dhe se në aktivitetet bujqësore dhe prodhuese, shërbimet në mënyrë progresive përbëjnë një përqindje më të madhe dhe në rritje të hyrjeve totale, direkte dhe indirekte të shfrytëzuara. Po ashtu, është treguar se një proces i «*përfshirjes së shërbimeve*» është duke u zhvilluar aktualisht në sektorin e prodhimit, ku shumë firma janë duke ofruar edhe shërbime në treg për krahasim produkteve të tyre. Në të njëjtën kohë, përdorimi i shtuar i teknologjisë nga shërbimet është duke ndryshuar strukturën e konkurrueshmërisë në sektorët që prodhojnë mallra; kështu që ka implikime për rritjen dhe produktivitetin e atyre sektorëve. Prandaj, shërbimet efikase janë thelbësore për zhvillimin e konkurrueshmërisë në sektorë të tjerë prodhues; dhe zhvillimi i prodhimit pa shërbime cilësore është i vështirë, për të mos thënë gati i pamundur; ndërsa në të njëjtën kohë, rritja e udhëhequr nga shërbimet pa një sektor industrial të integruar dhe konkurrues mund të çojë në ngadalësim të ndjeshëm të rritjes, deri në masën që burimet të alokohen për aktivitete me produktivitet më të ulët.

Digjitalizimi dhe rritja e ekonomisë së platformës dhe inovacioneve teknologjike në shërbime si transporti dhe logjistika, komunikimet mobile dhe shërbimet e ndërlidhura të vlerës së shtuar, si tregtia elektronike dhe pagesat elektronike; qasja në shërbime të informimit dhe ruajtje të të dhënave në mënyrë virtuale (*cloud*), ndër të tjera, janë duke ndryshuar tiparet e ekonomisë së shërbimeve. Këto trende potencialisht rrisin, në mënyrë të konsiderueshme, aftësinë e firmave të vogla për të kontestuar tregjet dhe për të ofruar produkte dhe shërbime për blerësit. Teknologjitë e reja u lejojnë firmave të vogla të shesin në tregje botërore, si dhe të ofrojnë shërbime për firmat më të mëdha që marrin pjesë në zinxhirët globalë të vlerave dhe për klientët vendorë.

Këto procese përhapëse tregojnë një integrim progresiv dhe të thelluar ndërmjet prodhimit të materialeve dhe shërbimeve; që duhet të përfshihen në përcaktimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit ekonomik. Duke pasur parasysh heterogjenitetin e aktiviteteve të shërbimeve, nuk ekziston politikë që është *e përshtatshme për gjithçka (no-one-fits-all policy)*, që do të akomodonte



të gjitha aktivitetet e shërbimeve, gjithashtu politikat duhet të pasqyrojnë specifikat e kushteve bazë në secilin vend. Prandaj, transpozimi i verbër i përvojave të vendeve të tjera nuk do të ishte i këshillueshëm.

Kërkohet një qasje iterative, adaptuese dhe fleksibile e politikave; si dhe caktimi i një kornize rregullative vendore të përshtatshme për aktivitetet e ndryshme të shërbimeve është vendimtar për të nxitur konkurrencën dhe për të përmirësuar efikasitetin. Megjithatë, politikat e shërbimeve duhet të sinkronizohen dhe artikulojnë në një vizion të përgjithshëm të një "strategjie gjithëpërfshirëse zhvillimore të industrisë së shërbimeve", e cila duhet të ofrojë udhëzime të duhura për natyrën dhe fushëveprimin e ndërhyrjeve sektoriale dhe për ndërveprimin e tyre, dhe sekuencën më të përshtatshme për zbatim. Strategjia e tillë duhet të përqendrohet në shërbimet e tregut, veçanërisht në zhvillimin e shërbimeve të biznesit, dhe një politikë e tregtisë së shërbimeve duhet të jetë një komponent kryesor i një strategjie gjithëpërfshirëse. Një numër vendesh që kanë parë rritjen e dukshme të prodhimit dhe produktivitetit të shërbimeve e kanë bërë këtë duke zhvilluar strategji gjithëpërfshirëse zhvillimore të industrisë së shërbimeve. Konsultimi dhe bashkëpunimi me sektorin privat, për të identifikuar mundësitë dhe për t'u marrë me kufizime specifike të rritjes, janë elemente të rëndësishme të këtyre strategjive.

III. EKONOMIA E SHËRBIMEVE TË KOSOVËS

Ekonomia e Kosovës është kryesisht një "ekonomi e shërbimeve". Sektori i shërbimeve ka dalë si segmenti më i madh i ekonomisë dhe si forcë e saj shtytëse, duke kontribuar me një përqindje në rritje të vlerës së shtuar vendore, punësim dhe tregti. Aktivitetet e shërbimeve në vitin 2017 përbënë 71.9 për qind të BPV-së me çmime bazë, dhe kanë gjeneruar 81.2 për qind të totalit të punësimit formal në vend. Eksportet e shërbimeve janë tre herë më të larta se eksportet e mallrave. Më e rëndësishme është se aktivitetet e shërbimeve përbëjnë shtyllën e sektorit privat të Kosovës. Aktivitetet e shërbimeve përbëjnë 86 për qind të totalit të firmave të regjistruara në vend dhe paraqesin 82.6 për qind të totalit të punësimit në sektorin privat; duke gjeneruar 87.3 për qind të totalit të qarkullimit të firmave në ekonomi dhe përfaqësojnë 88.8 për qind të shpenzimeve të përgjithshme³.

Ky seksion paraqet një eksplorim paraprak në sektorin e shërbimeve në ekonominë vendore të Kosovës. Synon të vlerësojë kontribuimin e këtyre aktiviteteve në rritje ekonomike dhe punësim dhe rolin e tij në procesin e transformimit afatgjatë strukturor të ekonomisë.

3.1. Struktura e sektorit të shërbimeve të Kosovës

Kontributi i lartë i aktiviteteve të shërbimeve në BPV dhe punësim është një atribut që ndahet nga shumica e ekonomive të varfra me burime të vogla. Megjithatë, në rastin e Kosovës, duhet të vihen në dukje tiparet e mëposhtme. Së pari, pjesëmarrja e shërbimeve në BPV është relativisht e lartë në krahasim me BPV-në e saj për kokë banori. Kosova paraqet një kontribut të shërbimeve ndaj totalit të vlerës së shtuar të gjeneruar në ekonomi të ngjashme me atë të vendeve të zhvilluara; dhe historikisht, pjesëmarrja e tillë ishte e lartë edhe në nivele më të ulëta të BPV-së për kokë banori. Kjo pasqyron paaftësinë për të zhvilluar një bazë prodhimi dhe kolapsin e sektorit të minierave. Kjo është ajo që quhet në letërsi *de-industrializimi i parakohshëm*. Së dyti, pjesëmarrja e lartë e shërbimeve në BPV është duke ndodhur në nivele më të ulëta të urbanizimit në krahasim

³ Të gjitha të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës



me vendet e tjera. Ekziston një lidhje e fortë ndërmjet niveleve të urbanizimit dhe kontributit të shërbimeve ndaj vlerës së shtuar; pasi shumë aktivitete të shërbimeve zhvillohen si rezultat i aglomerimit të popullsisë në qendrat urbane. Në këtë drejtim, Kosova shfaq një model anormal. Së fundi, ekziston një peshë e konsiderueshme e shërbimeve jo të tregut në kontributin total të shërbimeve ndaj BPV-së. Kjo shpjegohet nga madhësia e administratës publike dhe ofrimi i shërbimeve bazë kryesisht nga subjektet publike⁴.

Tabela 1⁵ paraqet evoluimin e strukturës së ekonomisë së Kosovës për periudhën 2009-2017. Të dhënat tregojnë qartë zhvendosjen progresive drejt shërbimeve; aktivitetet që kanë marrë 6.22 pikë përqindje të pjesëmarrjes në BPV-në totale. Të dhënat tregojnë BPV-në me çmime bazë, që lejon një vlerësim më të mirë, pasi tatimet dhe subvencionet nuk mund t'i atribuohen sektorëve të ndryshëm. Zhvendosja drejt shërbimeve ka qenë në kurriz të aktiviteteve të prodhimit të mallrave, në veçanti të bujqësisë dhe minierave. Prodhimi ka përjetuar një rënie të vogël në pjesëmarrjen e tij.

Brenda aktiviteteve të shërbimeve, transformimi kryesor ka qenë rënia relative e pjesëmarrjes së aktiviteteve të pasurive të paluajtshme dhe administratës publike dhe mbrojtjes në BPV-në totale, të cilat kanë përjetuar një zvogëlim të pjesëmarrjes së tyre në 4.3 pikë përqindjeje. Në të njëjtën kohë, aktivitetet kryesisht të pa-tregtueshme (tregtia me shumicë dhe pakicë, shërbimet arsimore dhe shëndetësore) kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në një proporcion të ngjashëm. Kontributi i rritur i energjisë elektrike është i dukshëm, ku distribucioni është një shërbim, si dhe shërbimet e informacionit dhe komunikimit.

Kolona e fundit e Tabelës 1 paraqet normën mesatare agregate të rritjes vjetore të sektorëve të ndryshëm të aktivitetit ekonomik; e cila ofron një pamje të dinamizmit afatgjatë dhe shpjegon ndryshimin strukturor që ka ndodhur. Siç mund të vërehet, një numër i sektorëve të shërbimeve kanë përjetuar norma të larta dyshifrore të rritjes gjatë periudhës së analizuar. Vlen të përmendet rritja e shërbimeve të argëtimit dhe rekreacionit; e shërbimeve të informimit dhe komunikimit, shërbimeve të akomodimit dhe ushqimit; shërbimeve shëndetësore; dhe shërbimeve administrative dhe mbështetëse. Normat diferenciale të rritjes, nëse vazhdojnë, mundësojnë parashikimin e rrugës në të cilën është duke kaluar transformimi i ekonomisë së Kosovës.

Figura 1⁶ paraqet strukturën e BPV-së së sektorit të shërbimeve në vitin 2017. Tregon pjesëmarrjen e nën-sektorëve të ndryshëm të shërbimeve në totalin e vlerës së shtuar të gjeneruar nga të gjitha shërbimet. Një tipar i rëndësishëm që duhet theksuar është se aktivitetet jo të tregtueshme kryesisht përbëjnë pjesën më të madhe të sektorit të shërbimeve. Shërbimet e administratës publike dhe të mbrojtjes, të pasurive të paluajtshme dhe të shitjes me shumicë dhe pakicë përbëjnë pothuajse gjysmën e vlerës së shtuar, të gjeneruar nga aktivitetet e shërbimeve në ekonominë e Kosovës. Ndërtimtaria kontribuon me një shtesë prej 11.9 për qind; dhe shërbimet arsimore dhe shëndetësore, të kombinuara, kontribuojnë me një shumë pak mbi 10 për qind. Mbizotëron ofrimi publik i shërbimeve arsimore dhe shëndetësore. Prandaj, nëse e shtojmë pjesëmarrjen publike në këto aktivitete për kontributin e administratës publike dhe mbrojtjes, kemi pak më shumë se një të pestën e totalit të vlerës së shtuar të gjeneruar nga shërbimet që rrjedhin në aktivitetet e sektorit publik⁷.

⁴ Këto tipare kërkojnë analizë të mëtejshme të thelluar.

⁵ Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

⁶ Burimi :Agjencia e Statistikave të Kosovës

⁷ Pjesëmarrja e sektorit publik në ofrimin e shërbimeve është një fushë që kërkon vlerësim të mëtejshëm për të rregulluar analizën dhe për të kuantifikuar më saktësisht kontributin e saj në BPV dhe punësimin total.



Nën-sektorët e shërbimeve që përfshijnë shërbimet e njohurive intensive të biznesit - shërbimet profesionale dhe shkencore, shërbimet administrative dhe mbështetëse, dhe shërbimet e informimit dhe komunikimit (të cilat, siç u diskutua më lart, janë më dinamike në mbarë botën dhe në qendër të transformimit ekonomik) kontribuojnë me 6.8 për qind të totalit të vlerës së shtuar të gjeneruar nga sektori i shërbimeve. Nevojiten informacione më të detajuara sipas aktivitetit specifik brenda këtyre nën-sektorëve për të shqyrtuar evoluimin dhe performancën e shërbimeve të biznesit në ekonomi dhe artikullimin e tyre me aktivitete të prodhimit të mallrave. Kjo është një fushë që duhet të marrë vëmendje prioritare në një agjendë të ardhshme të kërkimit⁸.

⁸ Në bazë të klasifikimit të ISIC, të paktën 4 shifra mbi vlerën e shtuar dhe të dhënat e punësimit do të duhet të ndërmerrej një vlerësim më gjithëpërfshirës.




Tabela 1. Kosova: Bruto Produkti Vendor sipas Aktivitetit Ekonomik Çmimet konstante [NACE Rev.2] në Mijëra EURO dhe %

	2009	%	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	%	Ndryshimi 2009-2017	Norma vjetore e rritjes
A Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	598306	17.33	583262	600286	561766	626312	643883	634700	618100	652148	12.83	-4.50	1.08
B Minierat dhe guroret	136335	3.95	129762	145968	151116	131451	123047	116460	114238	130617	2.57	-1.38	-0.53
C Prodhimi	478750	13.87	499952	461253	567724	585050	577245	603672	643248	686148	13.50	-0.37	4.60
D Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	97050	2.81	96827	112520	126746	138021	146627	173057	199104	217122	4.27	1.46	10.59
E Ujësjellësi; kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e rehabilitimit	24090	0.70	29491	36557	35379	51356	54322	55560	44675	45343	0.89	0.19	8.23
F Ndërtimtaria	282632	8.19	240982	334184	331192	350058	330653	387963	415083	429627	8.45	0.27	5.37
G Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	484820	14.04	565306	544962	564213	638730	708775	714134	743406	780094	15.35	1.31	6.13
H Transporti dhe magazinimi	133484	3.87	177711	219205	199747	217726	232851	211606	218277	226671	4.46	0.59	6.84
I Aktivitetet e shërbimeve të akomodimit dhe të ushqimit	22506	0.65	28510	34643	40516	38087	52177	53370	61328	73559	1.45	0.80	15.96
J Informimi dhe komunikimi	34678	1.00	34386	41547	59892	53414	115190	116426	110311	115358	2.27	1.27	16.21
K Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	145635	4.22	135892	165475	176255	202085	222652	259703	221402	230992	4.54	0.33	5.94
L Aktivitetet e pasurive të patundshme	425258	12.32	413921	415941	421706	455278	465944	499315	501599	496492	9.77	-2.55	1.95
M Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	47467	1.37	53519	66011	67894	75461	75036	87768	92675	95507	1.88	0.50	9.13
N Aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse	12372	0.36	11946	19278	20059	21680	21685	34088	34573	38119	0.75	0.39	15.10
O Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm social	380431	11.02	392296	440177	485660	505884	459833	430657	457033	470288	9.25	-1.76	2.69
P Arsimi	101675	2.94	118923	124433	157544	163479	169878	220414	237416	241068	4.74	1.80	11.39
Q Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe punës sociale	36121	1.05	45275	58933	68547	73291	82890	101518	109891	113864	2.24	1.19	15.43
R Arti, argëtimi dhe rekreacioni	3545	0.10	11812	15050	20347	23452	26978	23328	23940	25422	0.50	0.40	27.92
S Aktivitetet tjera të shërbimeve	7675	0.22	11265	8578	11964	8517	9164	10322	12977	13023	0.26	0.03	6.83
T Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënëse;	5	0.00	5	5	1	0	0	0	0	0	0.00	0.00	ND
% totale e shërbimeve e BPV-së		64.86									71.08	6.22	
VSHB me çmime bazë	3452833	100	3581047	3845006	4068267	4359332	4518832	4734060	4859275	5082462	100		4.95



Figura 1. Kosova: Struktura e sektorit të shërbimeve 2017



3.2. Punësimi në Aktivitetet e Shërbimeve

Tabela 2 paraqet shpërndarjen e punësimit sipas sektorit të aktivitetit ekonomik për periudhën 2012-2017. Në total, shërbimet përbëjnë 81.24 për qind të totalit të punësimit në ekonomi; dhe ajo që është shumë e rëndësishme është se këto aktivitete kanë kontribuar me 87.9 për qind të të gjitha vendeve të reja të punës të krijuara gjatë periudhës 2012-2017. Punësimi në aktivitetet e shërbimeve është i përqendruar në tregtinë me shumicë dhe pakicë, ndërtimtari, shërbimet e akomodimit dhe ushqimit, shërbimet arsimore dhe shëndetësore dhe administratë publike. Këto shërbime përbëjnë 89.96 për qind të totalit të punësimit në sektorin e shërbimeve. Duke pasur parasysh pjesëmarrjen e lartë të punësimit publik në arsim (33.7 mijë dhe shëndetësi 14.3 mijë



përkatësisht), totali i punësimit publik në shërbime paraqet pothuajse një në çdo katër persona që punojnë në aktivitete të shërbimeve (23.88 për qind).

Nën-sektorët më dinamikë në aspektin e gjenerimit të punësimit gjatë periudhës 2012-2017 kanë qenë ndërtimtaria; që ka rritur pjesëmarrjen në 3.4 pikë përqindjeje, aktivitetet e shërbimeve të akomodimit dhe ushqimit (rritje e pjesëmarrjes me 1.8 pikë përqindjeje), dhe shërbimet e tregtisë me shumicë dhe pakicë, duke rritur pjesëmarrjen në punësim në 1.3 pikë përqindjeje. Këta tre nën-sektorë të shërbimeve kanë kontribuar me 80.3 për qind të tërë punësimit të gjeneruar në sektorin e shërbimeve. Administrata publike dhe mbrojtja po ashtu ka kontribuar me 13.7 për qind të punësimit të gjeneruar gjatë periudhës në analizë. Siç mund të vërehet në tabelë, tetë nën-sektorë të shërbimeve kanë përjetuar një rënie në punësim në terma absolutë. Ky trend është në fushën që kërkon analizë të mëtejshme; që mund të jetë rezultat i teknologjive që kursejnë punën të prezantuar në këto aktivitete



Tabela 2. Kosova: Punësimi sipas Aktivitetit Ekonomik [Mijëra dhe %]

	2012	% of Total	2013	2014	2015	2016	2017	% e Totalit	Ndryshimi i % së Pjesëmarrjes	Ndryshimi absolut
A Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	13.9	4.6	20.3	8.6	6.7	14.2	15.9	4.4	-0.2	2000
B Minierat dhe guroret	3.6	1.2	4.3	3.6	2.5	3.6	4.2	1.2	0.0	600
C Prodhimi	43.4	14.3	43.1	44.9	43.9	44.2	47.5	13.2	-1.1	4100
D Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	7.0	2.3	5.8	5.7	5.3	5.5	6.6	1.8	-0.5	-400
E Ujësullësi, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave	3.6	1.2	4.1	3.4	4.4	6.7	4.3	1.2	0.0	700
F Ndërtimtaria	29.0	9.5	39.0	35.6	28.2	38.6	46.6	12.9	3.4	17600
G Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	40.8	13.4	43.6	46.8	42.9	49.5	52.8	14.7	1.3	12000
H Transporti dhe magazinimi	10.6	3.5	10.8	11.0	8.4	10.6	9.7	2.7	-0.8	-900
I Aktivitetet e shërbimeve të akomodimit dhe ushqimit	14.3	4.8	18.0	19.7	19.8	21.3	23.8	6.6	1.8	9500
J Informacioni dhe komunikimi	6.9	2.3	10.0	9.6	9.6	7.3	9.5	2.6	0.3	2600
K Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	6.8	2.2	7.6	5.9	5.9	6.5	6.3	1.7	-0.5	-500
L Aktivitetet e patundshmërive	0.7	0.2	0.6	0.2	0.3	0.3	0.2	0.1	-0.1	-500
M aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	5.6	1.8	7.0	6.5	5.5	6.6	7.9	2.2	0.4	2300
N Aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse	14.4	4.7	13.1	11.0	10.7	11.0	13.9	3.8	-0.9	-500
O Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	15.2	5.0	16.7	20.7	22.1	24.8	21.9	6.1	1.1	6700
P Arsimi	36.7	12.0	38.1	38.8	36.4	35.4	34.1	9.5	-2.5	-2600
Q Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe punës sociale	22.8	7.5	27.8	23.6	18.6	18.8	23.3	6.5	-1.0	500
R Artë, argëtimi dhe rekreacioni	6.7	2.2	6.0	4.7	4.4	5.6	5.0	1.4	-0.8	-1700
S Aktivitete të tjera të shërbimeve	11.9	3.9	12.5	11.1	12.5	12.1	15.7	4.4	0.5	3800
T *Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënëse	5.0	1.6	7.4	9.3	7.2	8.6	7.4	2.1	0.5	2400
U Aktivitetet e organizatave dhe organeve jashtë-territoriale	6.0	1.7	6.3	5.0	3.5	3.0	3.7	1	-0.7	-2300
Totali i shërbimeve	244.0	79.9					292.7	81.2	1.3	48700
Totali i punësimit	304.9	100.0					360.3	100		55400



3.3. Modeli i Ndryshimit Struktural të Ekonomisë së Kosovës

Natyrë e transformimit struktural është e rëndësishme për të kuptuar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Struktura e ekonomisë ka rëndësi për performancën e rritjes dhe zhvillimit, pasi sektorët kanë aftësi të ndryshme për të arritur dhe për të nxitur fitimet e produktivitetit dhe për të përfituar nga kërkesa e brendshme dhe e jashtme. Ajo që një vend prodhon dhe eksporton ka rëndësi për rritjen ekonomike, për shkak se aktivitetet ndryshojnë sa i përket potencialit të kthimit, kërkesës dhe përhapjes. Zhvillimi ekonomik bëhet një proces ku prodhimi lëviz gjithnjë e më shumë drejt aktiviteteve më të larta të produktivitetit me përhapje më të madhe teknologjike, kthime në rritje dhe elasticitet më të lartë të kërkesës. Ndryshimi struktural është nxitës i zhvillimit, dhe jo vetëm një nënprodukt. Ndryshimet strukturale të përmirësimit të rritjes ndodhin kur burimet shpërndahen në mënyrë progresive drejt aktiviteteve më të larta të produktivitetit. Në këtë seksion vlerësojmë natyrën e modelit të ndryshimeve strukturale të ekonomisë së Kosovës.

Ekonomia e Kosovës është shumë heterogjene në aspektin e produktivitetit sektorial të punës. Tabela 3⁹ paraqet produktivitetin e punës në sektorë të ndryshëm ekonomikë dhe evoluimin e saj gjatë periudhës 2012-2017. Duke pasur parasysh vështirësitë e të dhënave lidhur me punësimin efektiv në sektorin e bujqësisë, ne nuk e kemi përfshirë atë në analizë. Pjesa më e madhe e punësimit bujqësor janë punëtorë familjarë joformale dhe që nuk paguhen. Megjithatë, studime të ndryshme kanë treguar se sektori i bujqësisë ka një produktivitet shumë të ulët në Kosovë. Rritja që përmirëson transformimit struktural do të ndodhte me ri-alokimin e punës drejt aktiviteteve më të larta të produktivitetit në sektorët e prodhimit dhe shërbimeve. Të dhënat në Tabelën 3 tregojnë qartë nivelet e ndryshme të produktivitetit dhe ecurinë e ndryshme të sektorëve të ndryshëm sa i përket termave të shkallës mesatare vjetore të rritjes së produktivitetit. Ndërkohë që disa sektorë po tregojnë performancë pozitive të rritjes së produktivitetit, të tjerët po mbesin prapa; madje duke treguar trendë negative të rritjes së produktivitetit.

⁹ Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 3. Produktiviteti i Punës sipas Sektorit të Aktivitetit Ekonomik Jobujqësor [EURO]

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Rritja vjetore e produktivitetit (%)
B Miniera dhe gurthyes	41976.7	30570.0	34179.7	46583.9	31732.8	31099.3	-0.058
C Prodhimtari	13081.2	13574.2	12856.2	13751.1	14553.1	14445.2	0.020
D Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	18106.6	23796.7	25724.0	32652.2	36200.8	32897.3	0.127
E Ujësjellësi, kanalizimi, menaxhimit të mbeturinave dhe aktivitetet e rehabilitimit	9827.5	12525.9	15977.1	12627.3	6667.9	10544.9	0.014
F Ndërtimtaria	11420.4	8975.8	9288.0	13757.5	10753.4	9219.5	-0.042
G Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	13828.8	14649.8	15144.8	16646.5	15018.3	14774.5	0.013
H Transporti dhe magazinimi	18844.1	20159.8	21168.3	25191.2	20592.1	23368.1	0.044
I Aktivitetet e shërbimeve të akomodimit dhe ushqimit	2833.3	2115.9	2648.6	2695.5	2879.2	3090.7	0.018
J Informimi dhe komunikimi	8680.0	5341.4	11999.0	12127.7	15111.1	12142.9	0.069
K Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	25919.9	26590.1	37737.6	44017.5	34061.8	36665.4	0.072
L Aktivitet e patundshmërive	602437.1	758796.7	2329720.0	1664384.0	1671997.2	2482460.0	0.327
M Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	12123.9	10780.1	11544.0	15957.7	14041.6	12089.5	-0.001
N Aktivitetet e shërbimeve administrative dhe të mbështetjes	1393.0	1655.0	1971.4	3185.8	3143.0	2742.4	0.145
O Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm	31951.3	30292.5	22214.2	19486.7	18428.7	21474.3	-0.076
P Arsimi	4292.8	4290.8	4378.3	6055.3	6706.7	7069.4	0.105
Q Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe punës sociale	3006.4	2636.4	3512.3	5458.0	5845.3	4886.9	0.102
R Arti, argëtimi dhe rekreacioni	3036.9	3908.7	5740.0	5301.9	4274.9	5084.4	0.109
S Aktivitetet e shërbimeve tjera	1005.4	681.4	825.6	825.8	1072.5	829.5	-0.038



Rritja agregate e produktivitetit në ekonomi rezulton si nga: rritja brenda sektorëve të produktivitetit, rritja e produktivitetit nga firmat në sektorë; dhe gjithashtu si rezultat i ndryshimeve strukturore, duke u rritur punësimi i gjeneruar nga aktivitetet më të larta të produktivitetit. Pasi që sektorët ndryshojnë jo vetëm për nga aspekti i niveleve të produktivitetit, por edhe për nga drejtimi i trendit të rritjes së produktivitetit; alokimi i burimeve ka një efekt statik dhe dinamik. Efekti statik matë rritjen e produktivitetit të shkaktuar nga ndryshimi i modeleve të punësimit, ndërkohë që efekti dinamik kap zhvendosjet drejt sektorëve me ritme më të larta të rritjes së produktivitetit.

Figura 2. Kosova: Gjenerimi i punësimit sipas nivelit të produktivitetit 2012-2016





Figura 2 paraqet kontributin e secilit sektor të aktivitetit ekonomik në rritjen e punësimit për periudhën 2012-2017 dhe lidhjen e saj me produktivitetin relativ të sektorit. Siç mund të vërehet, ekonomia e Kosovës po gjeneron punësim në ata sektorë që kanë produktivitet më të ulët. Është e domosdoshme të theksohet se në sektorët me produktivitet më të lartë, punësimi mezi po rritet dhe më shqetësues është fakti që po zvogëlohet në shumë aktivitete të shërbimeve.

Figura 3 tenton të paraqes efektin dinamik të alokimit të burimeve. Ajo paraqet normat e rritjes së punësimit dhe të produktivitetit për sektorët e ndryshëm të ekonomisë. Në ata sektorë me normë më të lartë të rritjes së produktivitetit, rritja e punësimit është negative; ndërsa në sektorët me normë të ulët të rritjes së produktivitetit, norma e rritjes së punësimit është e konsiderueshme.

Figura 3. Kosova: Normat e rritjes së produktivitetit dhe punësimit



Analiza e shkurtër e mësipërme tregon se modeli i ndryshimit strukturor të ekonomisë së Kosovës mund të mos jetë shumë i favorshëm për një rritje të qëndrueshme ekonomike. Ekonomia e Kosovës është kryesisht një ekonomi shërbimesh dhe do të vazhdojë të jetë kështu edhe në të ardhmen. Sfidë është gjetja e mënyrave dhe mjeteve për të nxitur zhvillimin e teknologjisë më të lartë me aktivitete të shërbimeve me vlera më të larta, që mund të dalin si nxitës të rritjes dhe impuls i një ndryshimi strukturor i përmirësimit të rritjes së ekonomisë. Aktivitetet e shërbimeve mbështesin rritjen dhe zhvillimin e sektorëve të prodhimit material. Problemi kryesor është nëse vetëm funksionimi i lirë i forcave të tregjeve do të prodhojë ndryshimin e nevojshëm, ose nëse do të kërkohej politika aktive për të arritur rezultate të frytshme në këtë drejtim. Disa masa tashmë janë ndërmarrë, siç është miratimi i Ligjit mbi Shërbimet dhe miratimi i disa strategjive sektoriale që mbulojnë disa sektorë të shërbimeve. Por ajo që kërkohet është hartimi i një strategjie të përgjithshme, duke përfshirë një politikë tregtare të shërbimeve, e cila do të mundësojë krijimin e një sektori të fuqishëm dhe konkurrues të shërbimeve.

IV. TREGTIA NË SHËRBIME NË KOSOVË

Tregtia në shërbime është bërë një element shumë dinamik i procesit të globalizimit, dhe tregtimi i shërbimeve po rritet më shpejt se sa tregtimi i mallrave. Revolucioni i vazhdueshëm teknologjik dhe ndryshimet e konsiderueshme rregullative që kanë ndodhur në mbarë botën kanë nxitur dinamizmin e tregtisë në shërbime. Përlogaritjet e fundit të transaksioneve ndërkombëtare, të bëra në bazë të vlerës së shtuar, tregojnë se tregtia në shërbime përfaqëson gjysmën e tregtisë globale. Për shumë vende, tregtia në shërbime po shfaqet si instrument kryesor për integrimin e tyre në sistemin tregtar multilateral.

Sipas Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë në Shërbimeve (GATS), e cila ka miratuar një përkufizim të tregtisë në shërbime, e cila gjithashtu është inkuorporuar në Protokollin Shtesë 6 të Marrëveshjes së CEFTA-s, tregtia në shërbime kryhet nëpërmjet mënyrave të ndryshme të furnizimit.



KUTIA 2 ¹⁰

Metoda 1: Furnizimi ndërkufitar: është përcaktuar që të mbulojë rrjedhat e shërbimeve nga territori i një anëtari në territorin e një anëtari tjetër (p.sh. shërbimet bankare ose arkitekturore të transmetuara nëpërmjet telekomunikacionit ose postës);

Metoda 2: Konsumi jashtë vendit: i referohet situatave ku një konsumator i shërbimit (p.sh. turist ose pacient) kalon në territorin e një anëtari tjetër për të marrë një shërbim;

Metoda 3: Prania komerciale: nënkupton që një furnizues shërbimesh i një anëtari themelon një prani territoriale, përfshirë përmes pronësisë ose dhënies me qira të objekteve, në territorin e një anëtari tjetër për të ofruar një shërbim (p.sh. degët e brendshme të kompanive të sigurimeve të huaja ose zinxhirët e hoteleve); dhe

Metoda 4: Prania e personave fizik: përbëhet nga persona të një anëtari që hynë në territorin e një anëtari tjetër për të furnizuar një shërbim (p.sh. kontabilistët, mjekët ose mësuesit). Shtojca mbi Lëvizjen e Personave Fizik specifikon, megjithatë, se anëtarët mbeten të lirë që të ndërmarrin masa në lidhje me shtetësinë, vendbanimin ose qasjen në tregun e punës në baza të përhershme.

Ky seksion paraqet një vlerësim paraprak të tregtisë së Kosovës në shërbime. Analiza bazohet në të dhënat e Bilancit të Pagesave (BOP) nga Banka Qendrore e Kosovës, e cila regjistron transaksionet ndërmjet rezidentëve dhe jo-rezidentëve, të klasifikuar sipas kategorive të ndryshme. Tregtia ndërkombëtare në rrjedhat e shërbimeve paraqet transaksionet ndërmjet rezidentëve dhe jo-rezidentëve sipas dymbëdhjetë kategorive kryesore të shërbimit të klasifikimit të Bilancit të Zgjeruar të Shërbimeve të Pagesave (EBOPS 2010). Këto të dhëna nuk lejojnë të vlerësojnë plotësisht tregtinë në shërbime sipas mënyrës së furnizimit. Në veçanti, të dhënat e shfrytëzuara në këtë material nuk përfshijnë tregtinë sipas Metodës 3, prania komerciale; që quhet tregtia në shërbime e degëve dhe filialeve të huaja (FATS). Zhvillimi i mëtejshëm i statistikave mbi tregtinë në shërbime, sipas mënyrës së furnizimit dhe ndarjes më të madhe sipas llojit të shërbimit, duhet të jetë i lartë në prioritetet e agjendës së ardhshme të punës.

4.1 Pasqyra e tregtisë

Tregtia në shërbime mund të krijojë mundësi për Kosovën që të zgjerojë prodhimin e shërbimeve në sektorët ku ka një avantazh krahasues relativ, duke krijuar kështu vende pune, duke kontribuar më shumë në BPV dhe duke gjeneruar shkëmbime të huaja. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme për Kosovën, e cila ballafaqohet me kufizime në qasjen në tregjet ndërkombëtare për mallra për shkak të infrastrukturës së dobët të transportit, duke qenë pa dalje në det, dhe aktualisht duke mos qenë në gjendje të shfrytëzojnë në mënyrë efikase portet detare në Shqipëri ose Greqi.

Eksportet e shërbimeve mund të jenë dhe duhet të konsiderohen si një komponent i rëndësishëm i strategjisë së rritjes së vendit. Për më tepër, importet e shërbimeve mund të përmirësojnë ndjeshëm performancën e përgjithshme ekonomike duke rritur konkurrencën, duke sjellë praktikë më të mira ndërkombëtare, aftësitë dhe teknologjitë më të mira. Duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e tregtisë në shërbime kryhet nëpërmjet investimeve të huaja direkte, ajo gjithashtu mund të sjellë në vend kapitalin investues shumë të nevojshëm.


¹⁰ OBT/GATS 4 metodat e furnizimit



Figura 4 paraqet të dhënat agregate të Kosovës për tregtinë në shërbime për periudhën 2008-2017 sipas kategorive kryesore të shërbimeve. Tregtia në shërbime ka treguar dinamizëm gjatë kësaj periudhe, në të cilën ka patur një suficit të qëndrueshëm të tregtisë në shërbime. Eksportet e shërbimeve janë rritur me një normë mesatare vjetore rritjeje prej 12.9 përqind; ndërsa importet në 8.1 për qind. Si pasojë, ka pasur një rritje të suficitit. Në vitin 2008, suficiti tregtar i shërbimeve qëndroi në EUR 154.8 milionë, duke arritur në EUR 805.4 milionë në vitin 2017; duke treguar një normë rritjeje komplekse të bilancit pozitiv prej 17.93 për qind gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, suficiti i tregtisë në shërbime është luhatur në masë të konsiderueshme nga viti në vit.¹¹ Është e rëndësishme të theksohet se suficiti i tregtisë në shërbime jep një kontribut të rëndësishëm në financimin e llogarisë rrjedhëse.

Eksportet e shërbimeve janë rritur nga EUR 391.1 milionë në vitin 2008 në EUR 1 miliard e 319 milionë në vitin 2017; ndërkohë që importet janë rritur nga EUR 236.3 milionë në EUR 514.2 milionë në vitin 2017.

Figura 4. Kosova: Tregtia në shërbime



¹¹ Në vitin 2009, suficiti tregtar është rritur dhe arriti në EUR 235.4 milionë. Në vitin 2010 ai u ul në EUR 188.6 milionë. Në vitin 2011, bilanci arriti vlerën prej EUR 408.0 milion dhe vazhdoi të rritet deri në vitin 2013 me EUR 518.3 milion. Vitet e ardhshme në bilanc u ulën, dhe në vitin 2015 ajo ishte EUR 459.8 milionë. Për dy vitet e fundit shërbimet në Kosovë kanë një bilanc pozitiv, në vitin 2016 me EUR 642.5 milionë dhe në vitin 2017 ka arritur vlerën më të lartë prej EUR 805.4 milion.

Figura 5 paraqet përbërjen e eksporteve të shërbimeve gjatë periudhës raportuese sipas kategorive kryesore. Kutia 2 paraqet një shpjegim të shkurtër të transaksioneve që regjistrohen në kategoritë e ndryshme të shërbimeve. Eksportet kryesore të shërbimeve të Kosovës janë udhëtimi. Udhëtimi ka përfaqësuar pjesën më të madhe të eksporteve gjatë gjithë periudhës 2008-2017. Në vitin 2008, ajo ka shpjeguar 45 për qind të totalit të eksporteve dhe në vitin 2017 pjesëmarrja e saj është rritur në 81.6 për qind të totalit të eksporteve të shërbimeve. Shërbimet e udhëtimit në thelb llogariten për suficitin që Kosova regjistron në tregtinë në shërbime. Është shënuar një rënie e ndjeshme në vlerën e eksporteve të shërbimeve qeveritare për shkak të reduktimit të madhësisë dhe aktiviteteve të subjekteve të huaja, si EULEX, KFOR ndër të tjera, në territorin e Kosovës.

Rritja e eksporteve të shërbimeve të biznesit, që përfshijnë një shumëllojshmëri të gjerë të aktiviteteve të ndryshme, ka regjistruar një normë mesatare vjetore rritjeje prej 5.8 për qind dhe ky zhvillim duhet të theksohet. Eksportet e shërbimeve të transportit kanë mbetur praktikisht në të njëjtin nivel gjatë periudhës kur është bërë analiza.

Është shumë e rëndësishme që kjo pjesë të përfundohet, duke theksuar se eksporti i shërbimeve të Kosovës është kryesisht i bazuar në udhëtime, që është efekt i shpenzimeve të jo-rezidentëve në vend gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm. Në këtë aspekt, vizita e diasporës dhe paratë që ata shpenzojnë gjatë qëndrimit të tyre janë përbërës thelbësor i eksporteve totale të shërbimeve të udhëtimit. Ky lloj i eksportit mund të mos jetë i qëndrueshëm, dhe në të ardhmen e afërt mund të ketë një ndikim negativ në eksportin e përgjithshëm të shërbimeve.

Figura 5. Kosova: Eksporti i shërbimeve




Figura 6 paraqet përbërjen e importeve të shërbimeve të Kosovës për periudhën 2008-2017. Gjatë kësaj periudhe është rritur importi i shërbimeve, por me një ritëm më të ultë të rritjes sesa eksportet. Importet e shërbimeve janë më pak të përqendruara sesa në rastin e eksporteve; megjithatë, udhëtimi përbën gjithashtu importin kryesor. Kosova është importuese neto e shërbimeve të transportit; dhe gjithashtu një importues i konsiderueshëm i shërbimeve të biznesit.

Figura 6. Kosova: Importi i shërbimeve në Kosovë




Tabela 4. Shërbimet tregtare të Kosovës sipas sektorëve¹²

Viti	Transporti			Udhëtimi			Shërbimet biznesore			Shërbimet personale, kulturore dhe rekreative			Mallrat dhe shërbimet qeveritare			Shërbimet tregtare (Totali)		
	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci
2008	29.0	69.0	(40.0)	177.6	52.6	125.0	94.5	112.3	(17.8)	90.0	2.4	87.6	391.1	236.3	154.8
2009	30.1	69.2	(39.1)	277.6	82.1	195.5	127.0	128.4	(1.5)	0.8	0.1	0.7	81.4	1.7	79.7	516.9	281.5	235.4
2010	31.2	75.3	(44.1)	327.7	104.7	223.0	146.2	192.8	(46.6)	62.7	6.4	56.4	567.9	379.3	188.6
2011	28.6	82.0	(53.4)	531.6	157.3	374.4	200.1	164.6	35.4	0.0	0.0	0.0	51.6	0.0	51.6	811.9	403.9	408.0
2012	29.3	80.0	(50.7)	636.8	150.8	486.1	180.3	124.6	55.8	0.0	0.0	0.0	42.9	12.0	30.9	889.4	367.3	522.0
2013	36.5	88.0	(51.5)	647.5	135.3	512.2	138.0	103.6	34.4	0.0	0.0	0.0	39.0	15.8	23.2	861.1	342.8	518.3
2014	26.6	99.6	(73.0)	665.6	162.9	502.7	186.6	170.9	15.8	2.5	1.6	1.0	34.7	20.6	14.1	916.1	455.5	460.6
2015	33.1	146.7	(113.5)	719.7	193.2	526.6	148.4	118.3	30.1	1.6	0.8	0.8	34.8	18.8	16.0	937.7	477.8	459.8
2016	35.3	124.6	(89.2)	901.4	219.8	681.7	144.0	118.0	26.1	1.3	1.2	0.1	35.5	11.7	23.9	1117.6	475.1	642.5
2017	37.2	118.7	(81.5)	1,077.4	225.7	851.7	166.3	156.4	9.9	2.7	1.5	1.2	35.8	11.7	24.1	1319.5	514.2	805.4
Norma agregate e rritjes vjetore në %	2.52%	5.5		19.75	15.68		5.81	3.37		12.93	31.1		-8.81	17.16	-	12.93	8.09	

¹² Ky dokument shfrytëzon rezultatet paraprake për analizë. Vlerat në tabelë mund të dallojnë nga dokumentet zyrtare aktuale në Bankën Qendrore të Kosovës, për shkak të rafinimeve të zakonshme të bëra në raportet për tregtinë në shërbime. Kështu, mospërputhjet janë të parëndësishme dhe mund të mos përfillen sepse ky dokument analizon një trend të përgjithshëm të tregtisë në shërbime.



4.2 Modeli i Tregtisë së Shërbimeve të Kosovës

KUTIA 3

Termi tregtia ndërkombëtare në shërbime përfshin transaksionet e shërbimeve ndërmjet rezidentëve dhe jo-rezidentëve. Të dhënat e tregtisë në shërbime kryesisht grumbullohen me qëllim të elaborimit të bilancit të pagesave të ekonomisë. Përveç që ofrohen përmes tregtisë ndërmjet rezidentëve dhe jo-rezidentëve, shërbimet mund të ofrohen edhe nëpërmjet filialeve të huaja në vendet pritëse. Prandaj, fushëveprimi më i gjerë i tregtisë në shërbime shton edhe praninë komerciale të furnizuesve të shërbimeve. Ky komponent i fundit, tregtia e degëve të huaja në shërbime (FATS), nuk është ndërtuar për bilancin e pagesave. Ajo duhet të përlogaritet vetëm.

Transporti - Mbulon të ardhurat ndërkombëtare (faturat) dhe shpenzimet (pagesat) që lidhen me lëvizjen e njerëzve dhe mallrave nga një vend në tjetrin, dhe përfshin shërbimet ndihmëse dhe anësore si dhe shërbimet postare dhe korrierë. Transporti klasifikohet sipas: (a) mënyrës së transportit, gjegjësisht përmes detit, ajrit ose të tjera ("të tjera" mund të ndahen më tej në transportin përmes hekurudhave, rrugëve, rrugëve ujore të brendshme, kanaleve dhe transportit hapësinor, si dhe transmisionit të energjisë elektrike); dhe (b) asaj se çfarë është transportuar, udhëtarë ose mallra. Shërbimet postare dhe korrierë mbulojnë marrjen, transportin dhe shpërndarjen e letrave, gazetave, revistave, broshurave, materialeve të tjera të shtypura, plikove dhe paketave, duke përfshirë shërbimet korrierë me qera të postës dhe kutive postare.

Udhëtimi - Në rastin e udhëtimit, konsumatori lëviz në një territor tjetër për të konsumuar mallrat dhe shërbimet që ai ose ajo blenë. Kreditë e udhëtimit mbulojnë mallrat dhe shërbimet për përdorim vetanak ose për t'i dhuruar, të blera nga ndonjë ekonomi prej jo-rezidentëve gjatë vizitave në atë ekonomi; ndërkohë që borxhet mbulojnë mallrat dhe shërbimet për përdorim vetanak ose dhurimin e tyre, të blera nga ekonomitë e tjera prej rezidentëve gjatë vizitave në këto ekonomi të tjera. Zbërthimi standard i komponentës së udhëtimit është ndërmjet udhëtimit biznesorë dhe personal, me të dhëna plotësuese për grupet me interes të veçantë, siç janë punonjësit e zonës kufitare, ata sezonal dhe punonjës të tjerë afatshkurtër.

Shërbimet tjera biznesore – Përfshijnë një shumëllojshmëri të gjerë të shërbimeve të tregtueshme. Ato përbëhen nga shërbimet financiare, shërbimet e komunikimit dhe informimit; shërbimet kërkimore dhe zhvillimore, shërbimet e konsulencës profesionale dhe të menaxhimit, si dhe shërbimet teknike, tregtare dhe të tjera të biznesit. Shërbimet e kërkimit dhe zhvillimit përfshijnë shërbime të lidhura me kërkimin bazë dhe të aplikuar dhe zhvillimin eksperimental të produkteve dhe proceseve të reja. Shërbimet e konsulencës profesionale dhe të menaxhimit përfshijnë shërbimet juridike, të kontabilitetit, konsulencës së menaxhimit, shërbimet menaxheriale, shërbimet e marrëdhënieve me publikun, reklamimin dhe hulumtimin e tregut. Shumat e pranuar nga një kompani amë nga degët e saja për shpenzimet e përgjithshme të tejkaluara në lidhje me këto shërbime. Shërbimet teknike, tregtare dhe të tjera të biznesit përfshijnë arkitekturën dhe inxhinierinë, ndërtimtarinë, trajtimin e mbeturinave, lisingun operacional, shërbimet tregtare dhe të tjera të biznesit.

Shërbimet personale, kulturore dhe rekreative - Përbëhet nga (a) shërbimet audiovizuale dhe të ndërlidhura me to dhe (b) shërbimet tjera personale, kulturore dhe rekreative. Shërbimet audiovizuale dhe ato të ndërlidhura përbëhen nga shërbimet dhe tarifat që lidhen me prodhimin e filmave (në film, videokasetë, disk, ose të transmetuara në mënyrë elektronike, etj.), Programet radiotelevizive (në kohë reale ose të incizuara), dhe regjistrimet muzikore. Shërbimet e tjera personale, kulturore dhe rekreative përfshijnë shërbimet shëndetësore, shërbimet arsimore dhe të tjera. Shërbimet tjera personale, kulturore dhe rekreative përfshijnë ato që lidhen me muzetë dhe aktivitete të tjera kulturore, sportive, të lojërave të fatit dhe rekreative, përveç atyre që përfshihen në udhëtime.

Mallrat dhe shërbimet qeveritare; mallrat dhe shërbimet e blera nga ekonomia pritëse nga ana e diplomatëve, stafit konsullor dhe personelit ushtarak të vendosur jashtë vendit dhe vartësve të tyre; si dhe shërbimet e furnizuara nga dhe për qeveritë që nuk janë të përfshira në kategoritë e shërbimeve të tjera. Shërbimet e furnizuara nga dhe për qeveritë klasifikohen në kategoritë e shërbimeve specifike kur të dhënat e burimit e lejojnë një gjë të tillë.



Ky seksion jep një vlerësim të shkurtër dhe më të detajuar të tregtisë së Kosovës në shërbime. Ky seksion analizon tregtinë sipas llojit të shërbimit dhe disa aktivitetëve brenda secilës kategori¹³.

4.2.1 Transporti

Transporti nuk është thjeshtë mënyrë për të kapërcyer kufizimet fizike të distancës gjeografike për tregtinë ndërkombëtare, është një shërbim që tregtohet vetëm në të drejtën nga kompanitë e transportit me anije, linjat ajrore dhe një shumëllojshmëri e mënyrave të transportit të bazuar në sipërfaqe dhe shërbime të ndryshme ndihmëse. Shërbimet e transportit dhe logjistikës lehtësojnë tregtinë ndërkombëtare dhe luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen dhe zhvillimin e ekonomive. Cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve të transportit dhe logjistikës janë të rëndësishme për tregtinë ndërkombëtare, duke pas parasysh që shërbimet e dobëta dhe infrastruktura logjistike dhe proceset operacionale mund të jenë një pengesë e madhe për integrimin e tregtisë globale. Sa më në kohë, efikas dhe i besueshëm të jetë zinxhiri logjistik i furnizimit, aq më shumë mallra më efikase dhe më të besueshme mund të dërgohen nga pika e prodhimit deri në pikën e konsumit. Për më tepër, lidhjet e shumta në zinxhirin e furnizimit nënkuptojnë se një sektor transporti që funksionon mirë është i rëndësishëm për të realizuar potencialin e plotë të politikave të lehtësimit të tregtisë.

Kategoria e shërbimeve të transportit mund të ndahet në katër nënkategoritë: në transportin detar, transportin ajror, mënyrat e tjera të transportit, shërbimet postare dhe korrierë¹⁴. Tri nën-kategoritë e para nënkuptojnë më tej transportin e njerëzve ose të mallrave (dërgesave). Në rastin e transportit të udhëtarëve, tregtia ndërkombëtare në shërbimet e transportit mbulon të gjitha shërbimet që u ofrohen jo-rezidentëve nga transportuesit rezidentë, dhe rezidentëve nga transportuesit jo-rezidentë. Megjithatë, transporti i udhëtarëve (jo-rezidentëve) nuk është i përfshirë në transport. Në tregtinë ndërkombëtare, tregtia klasifikohet nën shërbimet e udhëtimit. Në rastin e shërbimeve të transportit të mallrave, shërbimet e transportit përfshijnë tërë transportin ndërkombëtar të eksporteve dhe importeve të mallrave të ekonomisë. Për më tepër, ajo përfshinë shërbimet e mallrave të ofruara nga operatorët rezidentë në importet e ekonomisë së mbledhjes brenda kufirit doganor të ekonomisë eksportuese (eksportet e shërbimeve të transportit të mallrave). Në rastin e Kosovës, për shkak të gjendjes së territorit saj pa dalje në det, transporti detar nuk është kategori relevante.

Figura 7 paraqet seritë kohore për evoluimin e tregtisë ndërkombëtare në shërbimet e transportit nga viti 2008 deri në vitin 2017. Në terma agregate, Kosova është importues neto i shërbimeve të transportit; dhe deficiti tregtar është rritur në mënyrë progresive që nga viti 2008. Eksporti i shërbimeve të transportit ka mbetur pothuajse i pandryshueshëm, me një normë mesatare vjetore rritjeje prej 2.5 përqind; ndërsa importet kanë regjistruar një normë mesatare vjetore rritjeje prej 5.6 përqind. Natyra e rritjes së konsiderueshme të importeve në vitin 2015 është relativisht e paqartë. Është vërejtur një paqëndrueshmëri e lartë në këtë sektor, përveç në periudhën 2014-2015. Megjithatë ekziston një ndryshim i konsiderueshëm në vlerën e eksporteve dhe importeve, duket se ndryshimi në vlerën e shërbimeve të importuara të transportit pasohet deri diku nga komponenti i eksportit.

¹³ Disa nën-sektorë janë bashkuar së bashku ose janë lënë tërësisht jashtë, për shkak të mungesës së tyre në këtë dokument.

¹⁴ Mënyrat e tjera të shërbimeve të transportit përfshijnë të gjitha metodat e tjera të transportit përveç detit dhe ajrit. Ato mund të ndahen në: transportin hapësinor, transportin hekurudhor, transportin rrugor, transportin përmes rrugëve të brendshme ujore, transportin përmes kanaleve, transmisionin e energjisë elektrike dhe shërbime të tjera mbështetëse dhe ndihmëse (p.sh. të gjitha shërbimet e tjera të transportit që nuk mund të ndahen në asnjërën prej komponentëve të shërbimeve të transportit të përshkruar më parë.



Figura 7. Kosova: Tregtia në shërbime të transportit





Figura 8 paraqet raportin e eksportit ndaj importit të shërbimeve të transportit. Gjatë periudhës 2008-2011 raporti ndërmjet eksporteve dhe importeve ishte gati i njëjtë, eksportet që mbulonin rreth 25 përqind të importeve; ndërsa për periudhën 2011-2013 raporti qëndronte në 30 përqind. Në vitin 2014 raporti ka rënë në mënyrë drastike në rreth 10%. Së fundmi, për periudhën 2015-2017 raporti ka qenë rreth 20 përqind. Fakti është se mbulimi i importeve të shërbimeve të transportit ka pësuar një rënie progresive, e cila përkthehet në një deficit tregtar në rritje, edhe pse me luhatje të konsiderueshme vjetore.

Figura 8. Raporti i mbulimit të importit për tregtinë në shërbimet e transportit




Historikisht ka patur raporte të ngushta ndërmjet tregtisë ndërkombëtare dhe transportit ndërkombëtar. Zhvillimi i tregtisë pasqyrohet në zhvillimin e transportit ndërkombëtar, pasi ekziston

një lidhje e konsiderueshme mes vëllimeve të tregtisë së mallrave dhe evoluimit të eksportit dhe importit të shërbimeve të transportit të mallrave.

Shërbimet e transportit ajror

Shërbimet e transportit ajror ndahen më tej në transportin e udhëtarëve, mallrave dhe shërbimeve të tjera. Figura 9 paraqet të dhënat e agreguara të serive kohore për eksportet dhe importet e shërbimeve të transportit ajror. Siç mund të vërehet, Kosova ka regjistruar një suficit në tregtinë e shërbimeve të transportit ajror gjatë periudhës 2008-2017, me përjashtim të vitit 2016 kur është regjistruar një deficit. Sidoqoftë, suficiti tregtar ka shfaqur një trend të rënies që nga viti 2012.

Figura 9. Kosova: Tregtia në shërbime të transportit ajror



Përbërja e tregtisë në këto shërbime meriton analiza të mëtejshme. Në rastin e transportit të udhëtarëve, Kosova varet kryesisht nga transportuesit e huaj, duke mos regjistruar eksportet e këtyre shërbimeve, pasi nuk ekziston një industri e mirë-zhvilluar kombëtare ajrore. Gjatë periudhës 2008-2017, transporti ajror i udhëtarëve ka përfaqësuar pjesën më të madhe të importeve të Kosovës për shërbimet e transportit ajror. Në vitin 2017, transporti i udhëtarëve përbënte 85 për qind të importeve të transportit ajror të Kosovës.


Në rastin e mallrave, gjegjësisht transporti i mallrave përmes ajrit, tregtia është shumë e kufizuar, thuhet inekzistente, pasi shumica e importeve të Kosovës kryhen përmes rrugëve tokësore. Eksportet e transportit ajror të mallrave praktikisht nuk ekzistojnë dhe importet gjatë periudhës 2015-2017 kanë pas një mesatare prej vetëm EUR 19,000. Eksporti kryesor i shërbimeve të transportit ajror, praktikisht të gjitha eksportet e regjistruara, dhe që shpjegon suficitin në këto shërbime, bien në kategorinë "të tjera", e cila pasqyron pagesat e bëra nga transportuesit e huaj në Kosovë për shërbimet që lidhen me transportin ajror.¹⁵ Në vitet e fundit, importet e operatorëve të tjerë të transportit ajror kanë treguar një trend të rritjes, edhe pse me luhatje të konsiderueshme.

¹⁵ Shërbimet e tjera të transportit përfshijnë shërbimet që janë ndihmëse për transportin dhe nuk sigurohen drejtpërsëdrejti për lëvizjen e mallrave dhe personave. Kjo kategori përfshin tarifën e trajtimit të ngarkesave të faturuara veçmas nga mallrat, magazinimin dhe deponimin, paketimin dhe ripaketimin, rimorkimin që nuk

Modalitetet e tjera të transportit

Modalitetet e tjera të transportit përfshijnë një shumëllojshmëri të mjeteve të ndryshme të transportit, duke përfshirë transportin rrugor, hekurudhor dhe transportin përmes rrugëve ujore, transportin përmes kanaleve dhe transportin hapësinor, si dhe transmisionin e energjisë elektrike. Në rastin e Kosovës, mënyra kryesore e transportit të regjistruar është transporti rrugor. Transporti rrugor mund të ndahet më tej në transportin e udhëtarëve, mallra dhe të tjera¹⁶. Figura 10 paraqet të dhënat e serive kohore të tregtisë në shërbimet e tjera të transportit për Kosovën për periudhën e cila është duke u analizuar.

Figura 10. Kosova: Tregtia në shërbime tjera të transportit



Importet e shërbimeve të transportit rrugor çdo vit tejkalojnë eksportet në masë të madhe, duke rezultuar në një deficit të vazhdueshëm dhe në rritje për Kosovën. Ky është reflektim i varësisë së lartë të tregtisë së Kosovës nga furnizuesit e shërbimeve të transportit të huaj. Deficiti në tregtinë e këtyre shërbimeve kap pothuajse dyfishin që nga viti 2008, duke u rritur nga EUR 48 milionë në EUR 87 milionë në vitin 2017. Shumica dërmuese e tregtisë së regjistruar është transporti i mallrave; që në vitin 2017 përfaqësonte 99.7 për qind të të gjitha importeve të këtyre shërbimeve. Në rastin e udhëtarëve, seria kohore ka regjistruar vetëm tregtinë që nga viti 2014, me vlera të ulëta si për eksportet ashtu edhe për importet; me një vlerë maksimale për eksportin prej EUR 184 mijë në vitin 2017 dhe për importin prej EUR 316 mijë në vitin 2016. Kosova ka regjistruar një suficit të vogël për dy vite dhe një deficit në dy vitet e tjera, për të cilat ekzistojnë të dhëna.

Evoluimi i tregtisë në transportin e mallrave lidhet ngushtë me trendët në tregtinë në mallra. Në rastin e Kosovës, është bërë një analizë për të vlerësuar shkallën e lidhjes ndërmjet importeve të

përfshihet në shërbimet e mallrave, pilotimin dhe ndihmat në navigim të transportuesve, kontrollin e trafikut ajror, pastrimin e kryer në porte dhe aeroporte të pajisjeve të transportit, dhe tarifave e agentëve që lidhen me transportin e udhëtarëve dhe mallrave (p.sh., shërbimet e transportit të tutjeshëm të mallrave dhe të brokerimit të mallrave).

¹⁶ Shërbimet e tjera të transportit përfshijnë shërbime mbështetëse dhe ndihmëse të transportit që nuk sigurohen drejtpërdrejt për lëvizjen e mallrave ose njerëzve, disa prej të cilave sigurohen edhe nga operatorët e transportit.

mallrave dhe importeve të shërbimeve të transportit të mallrave gjatë periudhës së analizës. Analiza e regresionit ka treguar një lidhje të konsiderueshme midis evoluimit të importeve të mallrave dhe importeve të shërbimeve të transportit të mallrave ($R^2 = 0.5531$). Rritja e importeve të mallrave, në mungesë të ndonjë ndryshimi në ofrimin e shërbimeve të transportit, do të prodhojë një rritje të njëkohshme të importit të shërbimeve të transportit të mallrave pak më shumë se gjysma e rritjes së importeve të mallrave. Kjo shkallë e shoqërimit gjithashtu tregon varësinë e Kosovës nga furnizuesit e jashtëm të shërbimeve të transportit. Një analizë e ngjashme është bërë për të vlerësuar lidhjen e eksportit të transportit të mallrave dhe eksportit të mallrave nga Kosova. Në këtë rast, nuk është gjetur ndonjë lidhje e mirëfilltë; duke sinjalizuar se edhe në rastin e eksporteve ekziston një varësi e lartë nga furnizuesit e huaj të transportit. Kjo mund të paraqet ndikimin e kufizimit që ballafaqohen ofruesit e shërbimeve të transportit në Kosovë e që operojnë në vendet fqinje.

Shërbimet postare dhe të korrierit

Periudha raportuese për të cilën ekzistojnë të dhëna për shërbimet postare dhe të korrierit është nga viti 2014 deri në vitin 2017. Një trend i paqëndrueshëm i tregtisë në këto shërbime është vërejtur në vitin 2014, shuma e eksportuar ishte EUR 2.3 milionë, duke u ulur gjatë vitit 2015 në EUR 1.5 milionë, dhe pastaj në vitin 2017 u ul në mënyrë drastike në EUR 206 mijë. Ndërkohë, importet e shërbimeve postare dhe të korrierit janë rritur nga EUR 686 mijë në vitin 2016, në EUR 1.2 milion në vitin 2017.


4.2.2 Udhëtimi

Udhëtimi regjistron shpenzimet për jo-rezidentët e huaj, ndërsa në Kosovë (eksportet), dhe ato të udhëtarëve të përkohshëm të Kosovës, ndërsa në vendet e huaja (importet). Njerëzit udhëtojnë në vende të tjera ose për qëllime biznesi ose për qëllime personale. Për sa i përket udhëtimit për qëllime personale, llogaritë regjistrojnë shpenzimet që kanë të bëjnë me shëndetin ose për qëllime arsimore, dhe për arsye të tjera, kryesisht për turizmin.

Udhëtimi është komponenti më i rëndësishëm i tregtisë së shërbimeve në rastin e Kosovës. Figura 11 paraqet periudhën kohore të evoluimit të tregtisë në këtë kategori shërbimesh për periudhën 2008-2017. Siç mund të vërehet, si eksportet ashtu edhe importet kanë treguar dinamizëm të konsiderueshëm gjatë kësaj periudhe; gjatë së cilës Kosova ka regjistruar një suficit tregtar të qëndrueshëm dhe në rritje; që arriti në EUR 871.7 milionë në vitin 2017. Gjatë kësaj periudhe eksportet janë rritur me një normë mesatare rritjeje prej 24.85 për qind, ndërsa importet me një normë prej 15.68 për qind.




Figura 11. Kosova: Tregtia në shërbime të udhëtimit



Në rastin e Kosovës, udhëtimi për qëllime personale, përveç atyre të biznesit, dominon tregtinë. Udhëtimi për qëllime biznesi, megjithëse tregon dinamizëm, përfaqëson një pjesë të vogël të totalit. Në vitin 2017, udhëtimet për qëllime të biznesit përfaqësonin vetëm 1.15 për qind të totalit të eksporteve të Kosovës, dhe vetëm 8.2 për qind të importeve totale në këtë kategori. Në udhëtimet për qëllime biznesi, Kosova ka shënuar një deficit në shumicën e viteve gjatë periudhës së analizuar. Megjithatë, rritja progresive e eksporteve tregon se më shumë njerëz po vijnë në Kosovë për të zhvilluar aktivitete të biznesit. Eksportet janë rritur nga EUR 114 mijë në vitin 2008, në EUR 12.4 milionë në vitin 2017. Nga ana e tyre, shpenzimet e shtetasve të Kosovës që udhëtojnë jashtë vendit për qëllime biznesi janë rritur nga EUR 1.17 milionë në EUR 18.5 milionë gjatë të njëjtës periudhë. Figura 12 paraqet evoluimin e serive kohore të udhëtimit për qëllime biznesi.

Figura 12. Kosova: Tregtia në udhëtime për qëllime biznesore



Në rastin e udhëtimit për qëllime personale, kategoria "të tjera" reflekton kryesisht turizmin. Ekziston një dinamizëm në rastin e udhëtimit për qëllime shëndetësore dhe arsimore, por vlera e tregtisë si për eksporte ashtu edhe për importe në këto raste është relativisht e ulët. Në të dyja rastet, Kosova ka shënuar një deficit të qëndrueshëm; duke sinjalizuar se vendi është një importues neto i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore. Në rastin e shërbimeve shëndetësore gjatë vitit 2017 Kosova ka importuar EUR 7.4 milionë, ndërsa ka eksportuar EUR 1.16 milionë. Në rastin e shërbimeve arsimore, importet arritën vlerën në EUR 6.6 milionë, ndërsa eksportet arritën vlerën në EUR 3.36 milionë.

Siç u përmend më lart, udhëtimi për qëllime të tjera personale, përfshirë për turizëm, përbën pjesën më të madhe të tregtisë së Kosovës që lidhet me këtë llogari. Në këtë rast, si eksportet ashtu edhe importet kanë treguar dinamizëm të konsiderueshëm. Eksportet janë rritur nga EUR 177 milionë në vitin 2008 në EUR 1,060 milionë në vitin 2017; ndërsa importet nga EUR 49.2 milionë në EUR 193.2 milionë gjatë të njëjtës periudhë. Eksportet janë rritur me një normë agregate të rritjes vjetore prej gati 20 përqind; dhe importet me një normë prej 14.6 për qind në vit. Kosova ka mbajtur një suficit tregtar në rritje, i cili në vitin 2017 ka arritur në EUR 867.3 milionë, nga suficiti prej EUR 128 milionë i arritur në vitin 2008. Një komponent i rëndësishëm i udhëtimit për qëllime personale përfshin udhëtimet e vizitave të ndërmarra nga diaspora e Kosovës. Sipas të dhënave të vitit 2017, nga 120 mijë vizitorë, pothuajse 30 përqind e tyre nuk janë bërë nga shtetasit e huaj. Për më tepër, shumë anëtarë të diasporës të gjeneratës së dytë posedojnë pasaporta të huaja. Një pjesë e konsiderueshme e vizitorëve vijnë nga vendet me një diasporë të konsiderueshme të Kosovës. Ndikimi i diasporës në llogarinë e udhëtimit është një çështje që meriton analiza të hollësishme të mëtejshme, pasi nuk është turizëm në kuptimin e ngushtë të fjalës.



4.2.3 Shërbimet e Biznesit

Tregtia në shërbimet e biznesit është një nga segmentet me rritjen më të shpejtë të tregtisë globale në shërbime. Kjo kategori përfshin një shumëllojshmëri të gjerë të aktiviteteve të ndryshme të shërbimeve, shumë prej të cilave janë inpute për sektorët e prodhimit material dhe gjithashtu për shërbime të tjera. Tabela 5 paraqet evoluimin e tregtisë së Kosovës në shërbimet e biznesit për periudhën gjatë së cilës është bërë analiza e kategorive të gjera të shërbimeve të biznesit të marra parasysh për këtë vlerësim.¹⁷ Siç mund të vërehet, ka pasur nivel të lartë të luhatjeve si në eksport ashtu edhe në import gjatë gjithë periudhës raportuese. Eksportet kanë dominuar mbi importet nga viti 2011 e tutje; megjithatë ekziston një trend i rënies së suficitit tregtar në tregtinë e këtyre shërbimeve; siç mund të shihet qartë në figurën 13. Suficiti më i lartë prej EUR 55.8 milionë është arritur gjatë vitit 2012. Suficiti tregtar në vitin 2017 ishte vetëm EUR 9.9 milionë.

¹⁷ Në këtë dokument tregtia në "shërbimet prodhuese për inputet fizike në pronësi të tjerëve", shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit; dhe "pagesat për përdorimin e pronës intelektuale nuk janë përfshirë; sa për të vlerësuar tregtinë e shërbimeve në aspektin e mbulimit të GATS dhe AP6. Në këtë kuptim ne kemi përfshirë shërbimet e ndërtimitarisë në këtë kategori.




Tabela 5. Kosova: Tregtia në shërbime të biznesit

	Ndërtimtaria			Sigurimi dhe shërbimet pensionale			Shërbimet financiare			Telekomunikacioni, shërbime kompjuterike dhe të informimit			Shërbimet e tjera të biznesit		
	<i>X</i>	<i>I</i>	<i>Bilanci</i>	<i>X</i>	<i>I</i>	<i>Bilanci</i>	<i>X</i>	<i>I</i>	<i>Bilanci</i>	<i>E</i>	<i>I</i>	<i>Bilanci</i>	<i>X</i>	<i>I</i>	<i>Bilanci</i>
2008	8.9	5.7	3.2	12.1	24.2	-12.1	2.7	2.5	0.1	57.3	20.4	36.9	13.6	59.5	-45.9
2009	15.7	5.0	10.7	14.8	24.4	-9.6	5.4	1.8	3.5	72.5	15.6	56.8	18.6	81.5	-62.9
2010	6.4	26.6	-20.2	15.5	28.4	-12.8	3.7	0.4	3.2	79.7	34.3	45.4	40.9	103.1	-62.2
2011	13.7	19.0	-5.3	13.9	31.0	-17.1	0.3	1.1	-0.8	96.9	20.1	76.8	75.3	93.5	-18.1
2012	22.4	11.4	11.0	25.3	29.2	-4.0	0.7	2.0	-1.3	70.4	23.0	47.4	61.6	58.9	2.7
2013	9.4	2.9	6.5	22.7	32.1	-9.4	2.0	2.7	-0.7	59.8	27.7	32.1	44.3	38.3	6.0
2014	12.0	7.7	4.4	21.8	35.9	-14.1	0.1	2.3	-2.2	77.7	58.2	19.5	75.0	66.8	8.2
2015	14.0	3.9	10.1	18.2	38.2	-20.0	0.5	3.2	-2.7	54.8	55.8	-1.0	60.9	17.2	43.7
2016	12.9	1.4	11.6	19.2	44.2	-24.9	0.5	3.5	-3.1	48.4	45.9	2.6	62.9	23.0	39.9
2017	9.3	1.4	7.9	19.7	41.6	-21.9	0.8	5.2	-4.4	46.6	51.3	-4.8	88.8	56.9	31.9



Figura 13. Kosova: Tregtia në shërbimet e biznesit




Tregtia në shërbimet e biznesit nuk ka qenë veçanërisht dinamike gjatë kësaj periudhe. Eksportet janë rritur me një normë agregate vjetore 5.8 për qind, ndërsa importet me 3.4 për qind. Që nga viti 2012, eksportet kanë mbetur të luhatshme rreth pothuajse të njëjtit nivel; siç ka qenë rasti edhe i importeve. Përveç kësaj, raporti i mbulimit të importit ka pësuar luhatje të lehtë.

Ndërtimtaria

Shërbimet e ndërtimtarisë shënojnë rekord ndërtimi jashtë vendit nga firmat e Kosovës dhe ndërtimi nga firmat e huaja në ekonominë raportuese. Figura 14 portretizon evoluimin e tregtisë në këto shërbime. Kosova ka ruajtur një suficit gjatë kësaj periudhe, me përjashtim të vitit 2010 kur ka pasur një rritje të konsiderueshme të importeve. Duhet të vihet në pah luhatshmëria e rëndësishme e vlerës së eksporteve, e cila reflekton natyrën e bazuar në projektin e kësaj tregtie. Importet e shërbimeve të ndërtimtarisë kanë pësuar një rënie të ndjeshme që nga viti 2012 dhe kanë qenë shumë të kufizuara në vitet e fundit të serive kohore. Ky është një aktivitet në të cilin Kosova mund të bëjë disa invadime të mtejshme në tregtinë e shërbimeve.

Figura 14. Kosova: Tregtia në shërbimet e ndërtimtarisë




Sigurimet dhe Shërbimet Pensionale

Kjo kategori, në rastin e Kosovës, kryesisht pasqyron tregtinë në shërbimet e sigurimeve, pasi nuk ka të dhëna për transaksione në shërbimet pensionale. Shërbimet e sigurimeve mbulojnë sigurimin e llojeve të ndryshme të sigurimeve për jo-rezidentët nga ndërmarrjet e sigurimeve rezidente dhe anasjelltas. Kosova është importuese neto e shërbimeve të sigurimit; duke treguar një deficit tregtar gjatë gjithë periudhës. Figura 15 paraqet evoluimin e tregtisë në këto shërbime. Nën shërbimet e sigurimit janë përfshirë tri transaksione të ndryshme: Sigurimi i drejtpërdrejtë, që mbulon lloje të ndryshme të sigurimeve të kontraktuara me jo-rezidentët si sigurimi i jetës, shëndetësor ose i transportit; ri-sigurimi i kontraktuar nga kompanitë e sigurimeve për të transferuar një masë të rrezikut; dhe shërbime të tjera ndihmëse të sigurimit, të cilat do të përfshijnë ndër të tjera agjentët e tjerë të sigurimeve. Në këto tri kategori ekziston një deficit tregtar i pandërprerë, që pasqyron zhvillimin e kufizuar të tregut të sigurimeve në Kosovë. Importet e shërbimeve të sigurimeve ndihmëse regjistrohen vetëm në katër vite deri për seritë kohore.

Sa i përket vlerës, sigurimi i drejtpërdrejtë përfaqëson pjesën më të madhe të tregtisë së Kosovës si në eksport ashtu edhe në import. Ka pasur një dinamizëm në tregtinë e këtyre shërbimeve. Eksporti i sigurimit të drejtpërdrejtë është rritur nga EUR 11.5 milionë gjatë vitit 2008, duke arritur në EUR 19 milionë gjatë vitit 2017. Nga ana e saj, importet janë rritur nga EUR 20 milionë në vitin 2008, deri në EUR 38 milionë. Nuk ka më të dhëna të ndara për publikun në lidhje me llojin e sigurimit të drejtpërdrejtë që tregtohet. Në vitin 2017, sigurimi i drejtpërdrejtë përfaqësoi 99 për qind të totalit të eksporteve të Kosovës për shërbimet e sigurimit; dhe 92.5 për qind të totalit të importeve.

Figura 15. Kosova: Tregtia në shërbimet e sigurimeve




Shërbimet Financiare

Sektori financiar luan një rol crucial në të gjitha ekonomitë. Në përgjithësi, tregtia në shërbimet financiare siç raportohet nga bilanci i pagesave është mjaft i kufizuar në rastin e Kosovës.¹⁸ Që nga viti 2008 eksportet kanë qenë në rënie dhe në vitet e fundit kanë treguar ndryshueshmëri të konsiderueshme. Nga ana e tyre, importet kanë treguar një trend në rritje; dhe që nga viti 2011 ka pasur një deficit tregtar të qëndrueshëm në këto shërbime, pas një suficiti gjatë periudhës 2008-2010. Shumica e tregtisë së Kosovës në shërbimet financiare kryhet nëpërmjet vendosjes së bankave të huaja në Kosovë; e cila (siç u diskutua më sipër) nuk është reflektuar në bilancin e pagesave dhe duhet të matet si tregti e shërbimeve të degëve/filialeve të huaja (FATS). Figura 16 paraqet evoluimin e tregtisë së Kosovës në shërbimet financiare siç raportohet në bilancin e pagesave.

¹⁸ Eksportet përfshijnë shërbimet financiare të matura në mënyrë indirekte të furnizuar në asetet e kredive dhe detyrimet e depozitave të korporatave financiare rezidente, për të cilat pala tjetër është një njësi jo-rezidente. Importet përfshijnë shërbime financiare të matura në mënyrë indirekte të blera nga njësi rezidente nga të gjithë sektorët institucionalë me korporatat financiare jo-rezidente.

Figura 16. Kosova: Tregtia në shërbime financiare



Shërbimet e Telekomunikacionit, kompjuterike dhe të informimit

Tregtia në këto shërbime është zgjeruar shumë shpejt gjatë viteve. Tabela 6 paraqet të dhënat për tregtinë në këto shërbime të ndara sipas komponentëve kryesorë.

Tabela 6. Shërbimet e telekomunikacionit, kompjuterike dhe të informimit

Viti	Shërbimet e Telekomunikacionit			Shërbime kompjuterike			Shërbime të informimit			Totali i shërbimeve të telekomunikacionit, kompjuterike dhe të informimit		
	X	I	Bilanci	X	I	Bilanci	X	I	Bilanci	X	I	Bilanci
2008	55.9	13.8	42.08	-	-	-	1.37	6.54	(5.16)	57.29	20.37	36.92
2009	70.5	12.1	58.34	-	-	-	1.96	3.47	(1.51)	72.47	15.64	56.93
2010	77.0	28.0	49.02	-	-	-	2.62	6.29	(3.66)	79.67	34.31	45.39
2011	94.5	17.5	77.03	-	-	-	2.30	2.55	(0.25)	96.85	20.07	76.78
2012	70.2	22.0	48.27	-	-	-	0.13	1.00	(0.86)	70.40	23.00	47.40
2013	56.7	23.6	33.12	1.27	1.97	(0.70)	1.71	2.07	(0.36)	59.75	27.70	32.05
2014	68.8	50.0	18.86	8.78	8.18	0.59	-	-	-	77.68	58.22	19.46
2015	40.5	39.8	0.65	14.3	15.9	(1.65)	-	-	-	54.82	55.82	(1.00)
2016	35.2	36.7	(1.43)	13.1	9.13	3.97	0.03	0.01	0.02	48.43	45.86	2.56
2017	49.6	40.2	9.35	14.8	10.9	3.92	0.14	0.07	0.07	64.68	51.33	13.34

Telekomunikacioni përfaqëson shumicën e transaksioneve tregtare të këtyre shërbimeve. Gjatë kësaj periudhe Kosova ka regjistruar një suficit të qëndrueshëm në tregtinë në telekomunikacionet




ndërkombëtare, megjithatë viteve të fundit suficiti ka rënë ndjeshëm. Në lidhje me tregtinë në shërbimet e telekomunikacionit, është e rëndësishme të theksohet se llogaria kryesisht pasqyron rezultatin e procesit të zgjidhjes së të ardhurave midis bartësve të trafikut ndërkombëtar të telekomunikacionit dhe varet nga vëllimi i trafikut në hyrje dhe dalje. Në këtë rast, një rrjedhje neto e trafikut do të rezultojë në një rrjedhje të pagesave neto nga vendi që "eksporton" atë trafik. Evoluimi i tregtisë po reflekton ndryshimet që kanë ndodhur në vëllimin dhe drejtimin e trafikut të telekomunikacionit ndërmjet Kosovës dhe pjesës tjetër të botës.

Një zhvillim interesant është dinamizmi që shërbimet e kompjuterike po shfaqin në vitet e fundit, si në aspektin e eksporteve ashtu edhe të importeve. Ka të dhëna vetëm nga viti 2012 e tutje. Siç mund të shihet në Figurën 17, Kosova ka qenë në gjendje të rikthejë deficitin tregtar dhe gjatë dy viteve të fundit ka përjetuar një suficit të serive kohore për të cilat ka të dhëna në dispozicion. Shërbimet kompjuterike përfshijnë softuerët kompjuterik dhe shërbimet e tjera kompjuterike. Do të ishte interesante që të ketë më shumë detaje mbi llojin e shërbimeve kompjuterike që Kosova është duke tregtuar. Në Kosovë zhvillimi i këtij sektori ka qenë i dukshëm me hyrjen në treg të kompanive të reja. Ky sektor mund të ofrojë një mundësi interesante për Kosovën që të diversifikojë eksportet drejt aktiviteteve me vlera më të larta.

Tregtia në shërbime të informimit, që mbulon shërbimet e agjencive të lajmeve dhe shërbimet tjera të informimit - duke përfshirë dhënien e lajmeve, fotografive dhe artikujve të paraqitjeve në media, dhe abonimet e drejtpërdrejta jo-përmbledhëse në gazeta dhe botime periodike nuk janë shumë të shprehura në rastin e Kosovës; dhe të dyja si eksportet dhe importet kanë shfaqur një rënie të konsiderueshme gjatë periudhës në analizë. Ajo që vërehet është rënia progresive e importeve nga 6.5 milionë euro në 2008, në vetëm 70.000 euro në vitin 2017. Faktorët që marrin parasysh trendin në tregtinë e këtyre shërbimeve do të kërkonin një analizë më të hollësishme.

Figura 17. Kosova: Tregtia në shërbime telekomunikacioni, kompjuterike dhe të informimit




Shërbime të tjera të Biznesit

Ky sektor përfshin tre nën-sektorë: shërbimet kërkimore dhe zhvillimore, të konsulencës profesionale dhe menaxheriale, teknike, që lidhen me tregtinë dhe shërbimet e tjera të biznesit. Në rastin e Kosovës nuk ka të dhëna për tregtinë në nën-sektorin e shërbimeve kërkimore dhe zhvillimore. Ky është një komponent i rëndësishëm i tregtisë së shërbimeve, pasi është mjeti përmes të cilit teknologjia transferohet në të gjitha vendet; pasi ajo përfshin punën e ndërmarrë në mënyrë sistematike për të rritur shkallën e njohurive. Do të ishte e përshtatshme për të shqyrtuar mënyrat dhe mjetet për të mbledhur të dhënat për tregtinë e këtij lloji të shërbimeve.

Në rastin e tregtisë së shërbimeve të konsulencës profesionale dhe menaxheriale, mund të vërehet një trend shumë interesant gjatë periudhës. Kosova ka qenë në gjendje të rikthejë deficitin tregtar që përjetoj gjatë periudhës 2008-2013 dhe të arrijë një suficit gjatë viteve në vazhdim. Gjatë vitit 2010 deficiti kishte arritur kulmin me EUR 75 milionë. Kjo ka qenë e mundur për shkak të një rritje të konsiderueshme të eksporteve, të cilat u rritën nga EUR 2 milionë në vitin 2008 në EUR 23.1 milionë në vitin 2017. Në të njëjtën kohë ka pasur një rënie dramatike të importeve nga piku i shumës prej EUR 86 milionë të arritura në vitin 2010, në vetëm EUR 12.4 milionë në vitin 2017. Ky trend mund të ketë sinjalizuar një proces të suksesshëm të zëvendësimit të importit, ku ofruesit vendorë të shërbimeve kanë qenë në gjendje të bëjnë invadim në tregun e brendshëm. Figura 18 paraqet evoluimin e tregtisë në këto shërbime.

Figura 18. Kosova: Tregtia në shërbimet e konsulencës profesionale dhe menaxheriale




Në rastin e shërbimeve teknike, tregtare dhe shërbimeve të tjera të biznesit, Kosova gjatë shtatë viteve të serive kohore ka qenë në gjendje të rrisë ndjeshëm eksportet e saj dhe të arrijë një suficit tregtar. Eksportet janë rritur nga EUR 11 milion në vitin 2008 në EUR 48.7 milion në vitin 2017, duke pasur një pik të shumës prej EUR 64.3 milion në vitin 2011. Në rastin e importeve, mund të vërehet një ndryshueshmëri më e lartë vjetore, ato janë luhatur nga një maksimum prej EUR 59.6 milion në vitin 2014 deri në një minimum prej EUR 7.2 milion në vitin 2015. Performanca e eksportit të Kosovës në këto shërbime është një shenjë shumë pozitive e potencialit për t'u bërë një faktor



ndërkombëtare në eksportin e disa shërbimeve me vlerë të shtuar. Figura 19 paraqet evoluimin e tregtisë në shërbimet teknike, tregtare dhe të tjera të biznesit.


Figura 19. Kosova: Tregtia në shërbimet teknike, tregtare dhe të tjera të biznesit



4.2.4 Shërbimet Personale, Kulturore dhe Rekreative

Kjo kategori regjistron transaksionet në shërbimet audio-vizuale dhe të ndërlidhura, shërbimet artistike dhe shërbimet e tjera personale, kulturore dhe rekreative. Në rastin e Kosovës, ka të dhëna vetëm për katër vite jo të vazhdueshme në serinë kohore dhe nuk ka të dhëna për shërbimet audio-vizuale dhe të ngjashme. Në rastin e shërbimeve të tjera personale, kulturore dhe rekreative për vitet për të cilat ka të dhëna, Kosova ka përjetuar një suficit tregtar. Megjithatë, vlera e tregtisë nuk është shumë e shprehur. Eksportet kulmore ishin në vitin 2017 me EUR 2.5 milionë; dhe importet kulmore në vitin 2015 me EUR 1.57 milionë. Figura 20 paraqet të dhënat në dispozicion për tregtinë në këto shërbime.

Figura 20. Kosova: Tregtia në shërbime personale, kulturore dhe rekreative



4.2.5 Shërbimet qeveritare

Kategoria e bilancit të pagesave "mallra dhe shërbime qeveritare" regjistron shpenzimet e subjekteve të jashtme diplomatike, stafit dhe personelit ushtarak që është vendosur jashtë vendit dhe vartësve të tyre, dhe shpenzime të ngjashme nga Kosova jashtë vendit, si dhe shërbimet e ofruara nga dhe për qeveritë që nuk janë të përfshira në asnjë kategori tjetër të shërbimeve. Kosova ka ruajtur suficitin gjatë periudhës së analizës. Në rastin e Kosovës, ka pasur një rënie të ndjeshme të eksporteve nga EUR 87.5 milionë në vitin 2008 në EUR 24 milionë në vitin 2017. Kjo ka qenë si rezultat i zvogëlimit të pranisë së personelit të huaj dhe subjekteve të ndryshme në vend, si dhe reduktimit të aktiviteteve të tyre. Në të njëjtën kohë, importet janë rritur ndjeshëm gjatë të njëjtës periudhë nga EUR 2.3 milionë deri në EUR 11.74 milionë në vitin 2017. Rritja e importeve është një reflektim i prezencës së zgjeruar të misioneve diplomatike të Kosovës dhe aktiviteteve të tjera në vendet e huaja.

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Sektori i shërbimeve, që është shtylla e ekonomisë së Kosovës, duhet të luajë një rol udhëheqës në promovimin e një ndryshimi strukturor gjithëpërfshirës të rritjes së ekonomisë. Analiza e bërë tregon se edhe pse shërbimet kanë qenë shumë dinamike në vitet e fundit, kontributi i tyre në rritje dhe zhvillim nuk është aspak siç duhet të jetë. Kosova po zgjeron aktivitetet e shërbimeve të produktivitetit të ulët dhe nuk ka artikulum të mjaftueshëm midis furnizimit të brendshëm të shërbimeve të biznesit dhe sektorëve të prodhimit material. Edhe pse tregtia në shërbime ka qenë dinamike gjatë dekadës së fundit, ekziston një varësi e fortë nga faturat e udhëtimit, që është sektori më i ngadalshëm i rritjes së tregtisë ndërkombëtare në shërbime dhe në rastin e Kosovës duket se vizitat familjare reflektojnë në masë të madhe më shumë se ato të turizmit në kuptimin e ngushtë të fjalës.

Ekziston një nevojë urgjente për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave statistikore mbi aktivitetet e shërbimeve, si në aspektin e llogarive kombëtare, duke gjeneruar shumë më shumë të dhëna të ndara në nivel sektorial; dhe gjithashtu në lidhje me tregtinë në shërbime, ekziston nevoja për të filluar gjenerimin e të dhënave më të hollësishme për kategoritë e shërbimeve të ndryshme dhe për FATS. Zbatimi progresiv i Doracakut të Statistikave (MSIT 2010) mbi Tregtinë në Shërbime do të ishte një instrument i përshtatshëm për të përmirësuar statistikën mbi tregtinë në shërbime.

Studimi aktual me sa jemi në dijeni është përafrimi i parë i ekonomisë së shërbimeve të Kosovës dhe roli i saj në rritjen dhe zhvillimin. Nevojitet vlerësim i mëtejshëm me analizë të plotë sektoriale për të mbledhur njohuritë që nevojiten për të ndërmarrë vendime të informuara mbi atë se si të garantohet që teknologjia më e lartë dhe shërbimet me vlerë më të madhe të shfaqen si motorët kryesorë të rritjes, si në vetvete ashtu edhe nëpërmjet kontributit të tyre në përmirësimin e produktivitetit të sektorëve të tjerë të aktivitetit ekonomik. Mbi këtë bazë, strategjia e zhvillimit të shërbimeve duhet të ngërthehet në agjendën qeveritare si prioritet i lartë; e cila si element thelbësor duhet të përfshijë një strategji për promovimin e shërbimeve të eksporteve. Sfidat me të cilën ballafaqohet Kosova është e frikshme; është e domosdoshme që të gjenden mënyra dhe mënyra për të ndryshuar modelin e ndryshimeve strukturore të ekonomisë; që assesi nuk do të jetë një detyrë e lehtë. Mirëpo, është një kusht i domosdoshëm nëse mund të sigurohet rritja e qëndrueshme e ekonomisë, si dhe përmirësimet e përgjithshme në mirëqenien e popullatës.

